						Zapod	Orgjost, Kosharisht, Pakisht, Zapod, Orçikël, Bele, Lojmë
						Shishtavec	Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Borje, Oreshkë, Cërnalevë
						Topojan	Topojan, Xhaferraj, Turaj, Brekije, Nimçë
						Bushtricë	Bushtricë, Gjegje, Matranxh, Palush, Vilë, Barruç, Shpat
						Gryk-Çajë	Fshat, Çajë, Buzëmadhe, Shkinak
						Kalis	Gështejë, Kodër-Gështejë, Kalis, Gurrë, Pralisht
						Surroj	Çinamak, Fusharë, Surroj, Aliaj
						Arrën	Arrën, Arrëz, Barrë, Vërrij, Tejmollë
						Kolsh	Kolsh, Mamëz, Myç-Mamëz
			Tropojë	Bajram Curri	Bajram Curri	Bajram Curri	Qyteti Bajram Curri
						Fierzë	Fierzë, Tpla, Dushaj i Poshtëm, Degë, Breg-Lum
						Lekbibaj	Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerreç Mulaj, Curraj i Sipërm
						Margegaj	Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam
						Llugaj	Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam
						Bujan	Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re
						Bytyç	Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Tropojë	Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlzen

QARKU LEZHË

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
IX	Lezhë	Lezhë	Kurbin	Laç	Kurbin	Laç	Qyteti Laç, Laç (Sanxhak)
						Milot	Milot, Skuraj, Mal Milot, Fushë Milot, Mal i Bardhë, Mal i Bardhë i Sipërm, Gallatë, Selitë, Gernac, Vinjoll, Shullaz, Prozhmë, Delbnisht, Ferr-Shkopet, Shkopet
						Fushë-Kuqe	Fushë-Kuqe, Adriatik, Patok, Gorre, Gurëz
					Mamurras	Mamurras	Qyteti Mamurras, Fushë-Mamurras, Shpërthet, Shëmri, Zhejë, Katund i Ri, Gjorm, Drojë
			Lezhë	Lezhë	Lezhë	Lezhë	Qyteti Lezhë
						Zejmen	Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten
						Shënkoll	Shënkoll, Rilë, Tale 1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk
						Balldren	Balldren, Mali-Kakariq, Qëndër-Kakariq, Gocaj, Balldren i Ri, Torovicë, Malecaj, Koljakaj
						Kallmet	Kallmet i Madh, Kallmet i Vogël, Rraboshtë, Mërqi
						Blinisht	Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajnë, Piraj, Baqel, Kodhel
						Dajç	Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragush, Kotërr, Zojs
						Ungrej	Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Ras-Butë, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi
						Kolsh	Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, Lalm Lukaj, Velë, Manati, Grykë, Barbullojë e Re
					Shëngjin	Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhë, Mali-Shëngjin, Mali-Rencit, Kodër Mulliri
			Mirditë	Rrëshen	Rrëshen	Rrëshen	Qyteti Rrëshen, Ndërfushas, Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë, Kulmë
						Selitë	Kurbnesh, Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth, Kumbull

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Kthellë	Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rrushkull, Ujë, Shtrezë
						Fan	Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall-Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz, Munellë
						Orosh	Reps, Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtërkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshejt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç, Lajthizë
						Kaçinar	Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf, Shpërdhezë
					Rubik	Rubik	Qyteti Rubik, Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Velës, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz, Bulger

QARKU SHKODËR

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
X	Shkodër	Shkodër	Malësi e Madhe	Koplik	Koplik	Koplik	Qyteti Koplik
						Gruemirë	Gruemirë, Boriç i Vogël, Grudë-Fushë, Grilë, Kurtë, Linajegç-Lepurosh, Omaraj, Rrash, Vorfë, Demiraj, Ktosh, Gjormë, Mshqerrë, Vajush, Boriç i Madh, Kerraj
						Kastrat	Bajzë, Ivanaj, Aliaj, Gradec, Hot, Jeran, Pjetroshan, Rapshë, Vukpalaj, Premal, Goraj-Budishtë, Kastrat, Bratosh
						Kelmend	Tamarë, Brojë, Kozhnje, Selcë, Vukël, Lëpushë, Vermosh, Nikç
						Qendër	Bogiç-Palvar, Dobër, Jubicë, Kamicë-Flakë, Kalldrun, Koplik i Sipërm, Stërbeq, Lohe e Poshtme
						Shkrel	Dedaj, Bogë, Bzhetë, Bzhetë-Markaj, Lohe e Sipërme, Vrith, Vuç-Kurtaj, Zagorë, Qaf-Gradë, Reç, Rrepisht, Kokpapaj
			Pukë	Pukë	Pukë	Pukë	Qyteti Pukë, Pukë, Lajthizë
						Gjegjan	Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul
						Rrapë	Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
					Fushë-Arrëz	Qelëz	Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël
						Qerret	Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet
						Fushë-Arrëz	Qyteti Fushë-Arrëz, Fushë-Arrëz, Miçaj, Lumëardhe
						Fierzë	Fierzë, Porav, Bugjon, Kokdodë, Arst, Miliska, Mëzi, Aprip-Guri
						Blerim	Flet, Xeth, Kulumri, Trun, Blerim, Dardhë, Qebik
						Qafë-Mali	Qafë-Mali, Armiraj, Srriqe, Mollkuqe, Lajthizë, Lumbardhë, Tuç, Kryezi, Orosh
						Iballë	Iballë, Sapaç, Levosh, Berishë e Vogël, Berishë Vendi, Berishë e Sipërme, Shopel, Mërtur
			Shkodër	Shkodër	Shkodër	Shkodër	Qyteti Shkodër
						Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar
						Bërdicë	Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj
						Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq
						Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor
						Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i Vjetër, Zues, Golem, Hot i Ri, Bleran, Bardhaj
						Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e Shtrenjtë, Domen, Shakotë, Vilëz
					Dukagjin	Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull, Prekal
						Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shalë, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Nderlysaj, Gimaj, Nënmavriq, Lotaj
						Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë
					Velipojë	Velipojë	Qyteti Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj
			Vau-Dejës	Vau-Dejës	Vau-Dejës	Vau-Dejës	Qyteti Vau-Dejës, Mjedë, Spatharë, Shelqet, Kaç, Naraç, Dush, Karmë, Gomsiqe
						Bushat	Bushat, Shkjezë, Plezhë, Kosmaç, Stajkë, Ashtë, Rranxa, Fshat i Ri, Mali i Jushit, Plepan-Konaj, Melgush, Barbullush, Kukël, Hoten
						Vig-Mnelë	Mnelë e Madhe, Mnelë e Vogël, Vig
						Hajmel	Hajmel, Dheu i Lehtë, Pistull, Paçram, Nënshatë

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Temal	Koman, Qerret, Arrë, Vilë, Telum, Kllogjen, Malagji-Kajvall, Toplanë, Sermë, Gushtë
						Shllak	Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushaj, Benë, Kroni i Madh, Barcollë, Vukaj, Uk-Bibaj

QARKU TIRANË

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
XI	Tiranë	Tiranë	Kamëz	Kamëz	Kamëz	Kamëz	Qyteti Kamëz, Bathore, Laknas, Valias, Frutikulturë, Bulçesh, Zall-Mner
						Paskuqan	Paskuqan, Babrru Qëndër, Kodër e Kuqe, Shpat, Fushë e Kërçikëve, Kodër Babrru, Paskuqan Fushë, Paskuqan Kodër
			Kavajë	Kavajë	Kavajë	Kavajë	Qyteti Kavajë
						Synej	Synej, Butaq, Rrikaj, Hajdaraj, Peqinaj, Rrakull, Bago
						Luz i Vogël	Luz i Vogël, Vorrozen, Beden, Blerimaj
						Golem	Golem, Kryemëdhej, Tilaj, Seferaj, Golemas, Qeret, Karpen, Zik-Xhafaj, Kanaparaj, Agonas, Karpen i Ri
						Helmas	Helmas, Zikular, Lis-Patros, Shtodhër, Çetë, Momël, Habilaj, Çollakaj, Kryezi, Cikallesh
					Rrogozhinë	Rrogozhinë	Qyteti Rrogozhinë, Rrogozhinë
						Kryevidh	Kryevidh, Ballaj, Rreth-Greth, Patkë-Milot, Zhabjak, Spanesh, Spille, Domën, Stërbeg, Shardushk, Kazie
						Sinaballaj	Sinaballaj, Methasanaj, Hazdushk, Hamenraj, Koçaj-Sheshaj, Thartor, Rrostej, Fliballije, Demarkaj
						Lekaj	Lekaj, Harizaj, German, Zambish, Mushnik, Mlik, Okshtun, Luz i Madh, Shkozet, Kryeluzaj
						Gosë	Gosë e Madhe, Gosë e Vogël, Kalush, Kërçukaj, Vilë-Ballaj
			Tiranë	Tiranë	Tiranë	Njësia Administrative nr.1	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.2	Pjesë e qytetit të Tiranës

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Njësia Administrative nr.3	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.4	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.5	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.6	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.7	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.8	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.9	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.10	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.11	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.12	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.13	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Njësia Administrative nr.14	Pjesë e qytetit të Tiranës
						Rinas	Rinas
						Petrelë	Petrelë, Mullet, Stërmas, Picall, Shënkoll, Gurrë e Madhe, Gurrë e Vogel, Daias, Barbas, Fikas, Mangull, Qeha, Shytaj, Hekal, Kryezi, Percëllesh, Durishtë

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
						Farkë	Farkë e Madhe, Farkë e Vogël, Lundër, Mjull Bathore, Sauk, Selitë
						Dajt	Linzë, Shishtufinë, Tujan, Brrar, Ferraj, Priskë e Madhe, Surrel, Lanabreges, Shkallë, Qafmollë, Darshen, Selbë, Murth
						Zall-Bastar	Zall-Bastar, Bastar i Mesëm, Bastar–Murriz, Vilëz, Zall-Mner, Mner i Sipërm, Bulçesh, Zall Dajt, Besh, Dajt, Shëngjin i Vogël, Selitë Mali
						Bërzhitë	Ibë, Bërzhitë, Dobresh, Ibë e Poshtme, Pëllumbas, Mihajas-Cirmë, Kus, Fravesh, Kllojkë, Pashkashesh, Lugë-Shalqizë, Rozaverë
						Krrabë	Krrabë, Mushqeta, Skuterë
						Baldushk	Baldushk, Mumajes, Fushas, Balshaban, Shpatë, Isufmuçaj, Mustafakoçaj, Koçaj, Kakunj, Vesqi, Parret, Shënkoll, Vrap, Shpat i Sipërm
						Shëngjergj	Shëngjergj, Verri, Urë, Burimas, Shëngjin, Façesh, Bizë, Fage, Parpujë, Vakumone, Domje, Derje
						Vaqarr	Vaqarr, Allgjatë, Arbanë, Bulticë, Damjan-Fortuzaj, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharrë
						Kashar	Kashar, Yzberish, Mëzez, Yrshek, Katundi i Ri, Kus, Mazrek
						Pezë	Pezë e Madhe, Pezë Helmës, Pezë e Vogël, Varosh, Maknor, Dorëz, Gror, Grecë, Pajanë, Gjysylkanë
						Ndroq	Ndroq, Zbarqe, Kërçukje, Zhurje, Lagje e Re, Pinet, Sauqet, Çalabërzezë, Shesh, Grebllesh, Mënik
						Zall-Herr	Zall-Herr, Dritas, Çerkezë-Morinë, Qinam, Kallmet, Herraj, Pinar, Priskë e Vogël, Radhesh
			Vorë	Vorë	Vorë	Vorë	Qyteti Vorë, Vorë, Marqinet, Shargë, Gërdec, Gjokaj, Kuc, Marikaj, Picar
						Prezë	Prezë, Ahmetaq, Palaq, Fushë Prezë, Gjeç-Kodër, Ndërmjetës, Breg-Shkozë
						Bërxullë	Bërxullë, Mukaj, Domje

QARKU VLORË

Nr.	Njësitë e qeverisjes vendore						
	Qarku	Qendra e Qarkut	Bashkia	Qendra e Bashkisë	Qyteti	Njësia administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
XII	Vlorë	Vlorë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Delvinë	Qyteti Delvinë, Bamatat, Vllahat, Rusan, Lefterhor, Kakodhiq, Sopot, Stjar, Vanë, Blerimas
						Vergo	Vergo, Tatzat, Kalasë, Fushë Vërri, Senicë, Kopaçez, Qafë Dardhë, Bajkaj
			Finiq	Fshati Dermish	Finiq	Livadhja	Livadhja, Kulluricë, Llazat, Kalcat, Kodër, Lefter Talo, Gravë, Qesarat, Komat, Karroq, Grazhdan, Zminec, Sopik, Pandalejmon, Vagalat
						Dhivër	Dhivër, Rumanxë, Memoraq, Navaricë, Dermish, Leshnicë e Sipërme, Leshnicë e Poshtme, Janicat, Llupsat, Cerkovicë, Shëndre, Malcan
						Aliko	Aliko, Çaush, Neohor, Tremul, Rahullë, Pllakë, Jermë, Vurgu i Ri, Halo, Dritas
						Finiq	Finiq, Buronjë, Çlirim, Vrion, Karahaxhë, Bregas
						Mesopotam	Mesopotam, Dhrovjan, Krongj, Bistricë, Velahovë, Livinë, Brajlat, Sirakat, Kostar, Fitore, Krane, Ardhasovë, Kardhikaq, Pecë, Muzinë
			Himarë	Himarë	Himarë	Himarë	Qyteti Himarë, Pilur, Kudhës, Qeparo fshat, Qeparo Fushë, Vuno, Iliaz, Dhërmi, Gjilekë, Palasë
						Lukovë	Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shënvasil, Nivicë
						Horë-Vranisht	Vranisht, Kuç, Kuç Buronjë, Bolenë, Kallarat, Tërbaç
			Konispol	Konispol	Konispol	Konispol	Qyteti Konispol, Çiflik
						Xarrë	Xarrë, Mursi, Shkallë, Vrinë, Shëndëlli
						Markat	Dishat, Vërvë, Shalës, Markat, Ninat, Janjar
			Sarandë	Sarandë	Sarandë	Sarandë	Qyteti Sarandë, Gjashtë, Metoq, Çukë, Shelegar
						Ksamil	Ksamil
			Vlorë	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Qyteti Vlorë
						Qendër Vlorë	Bestrovë, Babicë e Madhe, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kaninë, Kërkovë, Nartë, Sherishtë, Panaja, Xhyherinë, Zvërnec, Sazan
						Novoselë	Novoselë, Aliban, Bishan, Mifol, Poro, Dëllenjë, Delisuf, Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, Fitore, Akërni
						Shushicë	Shushicë, Bunavi, Beshisht, Grabian, Drithas, Mekat, Llakatund, Çeprat, Risili
					Orikum	Orikum	Qyteti Orikum, Dukat, Dukat Fshat, Tragjas, Radhimë
					Selenicë	Selenicë	Qyteti Selenicë

Qarku	Bashkia	Qytetet përbërëse (nr. NjA)
	Tropojë	Tropojë (8)
Lezhë	Lezhë	Lezhë (9); Shëngjin (1)
	Mirditë	Rrëshen (6); Rubik (1)
	Kurbin	Kurbin (3); Mamurras (1)
Shkodër	Malësi e Madhe	Koplik (6)
	Shkodër	Shkodër (7); Dukagjin (3); Velipojë (1)
	Vau-Dejës	Vau-Dejës (6)
	Pukë *	Pukë (5); Fushë-Arrëz (5)
Tiranë	Tiranë	Tiranë (28)
	Kamëz	Kamëz (2)
	Vorë	Vorë (3)
	Kavajë *	Kavajë (5); Rrogozhinë (5)
Vlorë	Vlorë *	Vlorë (4); Orikum (1); Selenicë (6)
	Himarë	Himarë (3)
	Sarandë	Sarandë (2)
	Konispol	Konispol (3)
	Finiq	Finiq (5)
	Delvinë	Delvinë (2)

IX. RREGULLIMI I ÇËSHTJEVE FINANCIARE, PASURORE DHE DETYRIMEVE

Aneksi përbën analizë paraprake mbi rregullimin e çështjeve financiare dhe të detyrimeve. Nisma ligjore do t'i dërgohet për mendim Këshillit të Ministrave. Pas marrjes së mendimit të tij dhe veçanërisht të Ministrisë së Financave për rregullimin përfundimtar të çështjeve financiare, pasurore dhe të detyrimeve ndaj të tretëve, teksti i ligjit dhe relacioni do të reflektojnë në mënyrë përfundimtare këto aspekte si masat për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve gjatë periudhës kalimtare.

KUVENDI I SHQIPËRISË

Grup deputetësh — nismë ligjvënëse sipas nenit 81, pika 1, të Kushtetutës

RAPORT SHOQËRUES

i projektligjit "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore
në Republikën e Shqipërisë" (në zëvendësim të ligjit nr. 115/2014)

PJESA A — KORNIZA E PËRBASHKËT · PJESA B — DOSJET E 13 KONSOLIDIMEVE
PJESA C — ÇËSHTJET E PËRBASHKËTA TË ZBATIMIT · ANEKSET

Hartuar në zbatim të nenit 108, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 89 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", mbi bazën e Raportit Përfundimtar të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale (RAT 2.0)

PËRMBAJTJA

Matrica e konformitetit: 7 kriteret ligjore ↔ seksionet e raportit 25

PJESA A — KORNIZA E PËRBASHKËT 26

A.1 Hyrje, qëllimi dhe objekti i raportit .....

A.2 Baza kushtetuese dhe ligjore .....

A.3 Konteksti: bilanci i reformës së vitit 2014 dhe realiteti i ri .....

A.4 Baza e evidencës: Raporti Përfundimtar i Komisionit të Posaçëm (RAT 2.0) .....

A.5 Metodologjia e vlerësimit: tre indekse dhe dy kritere .....

A.6 Parimet e vendimmarrjes për përzgjedhjen e rasteve .....

A.7 Objekti i projektligjit: 13 konsolidimet e propozuara .....

A.8 Struktura e re e organizimit të brendshëm: Bashki → Qytet → Njësi Administrative .....

A.9 Mendimi i popullatës: kuadri i përgjithshëm i konsultimit .....

A.10 Përfitimet e pritshme në nivel kombëtar .....

PJESA B — DOSJET E TREMBËDHJETË KONSOLIDIMEVE 34

B.1 Konsolidimi i bashkive Fushë-Arrëz dhe Pukë në Bashkinë Pukë .....

B.2 Konsolidimi i bashkive Klos dhe Mat në Bashkinë Mat .....

B.3 Konsolidimi i bashkive Rrogozhinë dhe Kavajë në Bashkinë Kavajë .....

B.4 Konsolidimi i bashkive Berat, Dimal dhe Poliçan në Bashkinë Berat .....

B.5 Konsolidimi i bashkive Patos dhe Fier në Bashkinë Fier .....

B.6 Konsolidimi i bashkive Divjakë dhe Lushnjë në Bashkinë Lushnjë .....

B.7 Konsolidimi i bashkive Selenicë dhe Vlorë në Bashkinë Vlorë .....

B.8 Konsolidimi i bashkive Maliq dhe Korçë në Bashkinë Korçë .....

B.9 Konsolidimi i bashkive Këlcyrë dhe Përmet në Bashkinë Përmet .....

B.10 Konsolidimi i bashkive Memaliaj dhe Tepelenë në Bashkinë Tepelenë .....

B.11 Konsolidimi i bashkive Libohovë dhe Gjirokastër në Bashkinë Gjirokastër .....

B.12 Konsolidimi i bashkive Elbasan, Cërrik dhe Belsh në Bashkinë Elbasan .....

B.13 Konsolidimi i bashkive Prrenjas dhe Librazhd në Bashkinë Librazhd .....

PJESA C — ÇËSHTJET E PËRBASHKËTA TË ZBATIMIT 107

C.1 Vazhdimësia juridike, financiar dhe pasuror .....

C.2 Administrata dhe personeli .....

C.3 Qytetet dhe njësitë administrative si garanci identitare .....

C.4 Kalendari i tranzicionit .....

C.5 Analiza e rrezikut dhe masat zbutëse .....

ANEKSET 109

Aneksi A — Treguesit IFB, IPE, IMU për 28 bashkitë e përfshira .....

Aneksi B — Matrica e distancave dhe kohëve të udhëtimit .....

Aneksi C — Tabela e plotë e ndarjes së re: bashkitë, qytetet dhe njësitë administrative .....

Aneksi D — Metodologjia e indekseve (përmbledhje teknike) .....

Aneksi E — Përmbledhja e dëgjesave publike dhe dokumentimi i konsultimit .....

Matrica e konformitetit: 7 kriteret ligjore ↔ seksionet e raportit

Neni 108, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 89 i ligjit nr. 139/2015 përcaktojnë faktet dhe argumentet që duhet ta shoqërojnë detyrimisht çdo propozim riorganizimi. Tabela tregon ku plotësohet secili prej 7 kritereve; kriteret 1–5 dhe 7 plotësohen për secilin rast në Pjesën B, ndërsa korniza e përbashkët jepet në Pjesën A.

Kriteri kushtetues / ligjor	Baza ligjore	Ku trajtohet
1. Riorganizimi mbi bazën e nevojave e interesave të përbashkët ekonomikë dhe traditës historike	Neni 108/2 i Kushtetutës	Pjesa B, seksioni X.3 (për çdo rast); Pjesa A.3
2. Arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative dhe avantazhet e riorganizimit	Neni 89, shkronja "a", ligji 139/2015	Pjesa B, seksioni X.4 (5 nën-dimensione me evidencë nga IFB/IPE/IMU)
3. Mendimi i popullatës që banon në njësitë që riorganizohen	Neni 108/2; neni 89 "b"	Pjesa A.9 (procesi); Pjesa B, seksioni X.7 (për çdo rast)
4. Hartat administrativo-territoriale me ndryshimet	Neni 89, shkronja "c"	Pjesa B, seksioni X.8 (harta dhe organizimi i brendshëm); Anekset C–D
5. Rregullimi i çështjeve financiare dhe i detyrimeve ndaj të tretëve ose ndaj njëra-tjetrës	Neni 89, shkronja "ç"	Pjesa B, seksioni X.9; Pjesa C.1–C.2
6. Realizimi në nivel më të lartë i funksioneve / zbatimi i politikave të zhvillimit vendor, rajonal e më gjerë	Nenet 88–89, fryma e ligjit 139/2015	Pjesa B, seksioni X.10; Pjesa A.10
7. Përfitimet nga zbatimi i reformës administrativo-territoriale	Praktika parlamentare; relacioni	Pjesa B, seksioni X.11; Pjesa A.10

PJESA A — KORNIZA E PËRBASHKËT

A.1 Hyrje, qëllimi dhe objekti i raportit

Ky raport shoqëron projektligjin "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", depozituar në Kuvend nga një grup deputetësh në ushtrim të së drejtës së nismës ligjvënëse sipas nenit 81, pika 1, të Kushtetutës. Qëllimi i tij është të paraqesë, për çdo rast riorganizimi, faktet dhe argumentet që Kushtetuta dhe ligji organik i vetëqeverisjes vendore i kërkojnë shprehimisht si shoqërues të detyrueshëm të një propozimi për ndryshimin e ndarjes administrativo-territoriale.

Objekti i projektligjit është konsolidimi territorial: 28 bashki ekzistuese konsolidohen në 13 bashki, duke e zbritur numrin e bashkive në shkallë vendi nga 61 në 46. Propozimi nuk krijon asnjë njësi të re, nuk ndan asnjë njësi ekzistuese dhe nuk prek asnjë nga bashkitë me veçori identitare, minoritare a largësie të skajshme, të cilat trajtohen si raste të veçanta dhe ruhen të paprekura. Krahas hartës, projektligji sanksionon edhe strukturën e re të organizimit të brendshëm të bashkisë — Bashki → Qytet → Njësi Administrative — me 71 qytete dhe 387 njësi administrative në shkallë vendi (seksioni A.8).

Raporti mbështetet tërësisht në bazën e evidencës të krijuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, mandati i të cilit përfundoi më 15 korrik 2026. Nisma ligjvënëse që ky raport shoqëron është e pavarur nga Komisioni, por e ndërton propozimin e saj mbi Raportin Përfundimtar të tij (~350 faqe), mbi sistemin e indekseve bashkiake të ndërtuar nga grupi i ekspertëve dhe mbi gjetjet e njëmbëdhjetë dëgjesave publike rajonale të zhvilluara në periudhën prill–qershor 2026.

A.2 Baza kushtetuese dhe ligjore

Neni 108, pika 2, i Kushtetutës përcakton dy kushte themelore për çdo ndryshim të ndarjes administrativo-territoriale: së pari, ndarjet "caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike"; së dyti, "kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to". Këto dy kushte përshkojnë të gjithë strukturën e këtij raporti: çdo dosje e Pjesës B hapet me analizën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike (seksioni X.3) dhe përmban seksionin e posaçëm të mendimit të popullatës (seksioni X.7).

Neni 89 i ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton se riorganizimi i ndarjes administrativo-territoriale bëhet me ligj të veçantë dhe se propozimi, për çdo rast të veçantë, i paraqitet Kuvendit së bashku me: (a) arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike dhe administrative për nevojën dhe avantazhet e riorganizimit; (b) mendimin e popullatës që banon në njësitë që do të riorganizohen; (c) hartat administrativo-territoriale me ndryshimet përkatëse; dhe (ç) mënyrat e rregullimit të çështjeve financiare e të detyrimeve. Formulimi "për çdo rast të veçantë" dikton arkitekturën e Pjesës B: trembëdhjetë dosje të pavarura, juridikisht të vetëmjaftueshme, një për secilën bashki të konsoliduar; dosjet e Beratit (B.4) dhe të Elbasanit (B.12) trajtojnë secila konsolidimin e tre bashkive në një njësi të vetme.

Miratimi i projektligjit kërkon shumicën e cilësuar prej tre të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sipas nenit 81, pika 2, shkronja "f", e Kushtetutës. Korniza plotësohet nga nenet 86–93 të ligjit nr. 139/2015 (procedura e riorganizimit), nga ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (pasojat financiare të riorganizimit), nga vendimi nr. 19/2015 i Gjykatës Kushtetuese (hapësira e vlerësimit të ligjvënësit dhe standardi i konsultimit paraprak), nga Karta Europiane e Autonomisë Vendore — neni 5

i së cilës kërkon konsultimin paraprak të bashkësive vendore për çdo ndryshim kufijsh — si dhe nga standardet e Komisionit të Venecias, sipas të cilave ndryshimet territoriale duhet të përfundojnë të paktën një vit para zgjedhjeve vendore.

A.3 Konteksti: bilanci i reformës së vitit 2014 dhe realiteti i ri

Reforma e vitit 2014 konsolidoi 373 njësi vendore në 61 bashki dhe rezultatet e saj dhjetëvjeçare janë të matshme: ndërmjet viteve 2015 dhe 2025 shpenzimet vendore u rritën me rreth 172% (nga 2,4% në 3,5% të PBB-së), të ardhurat e veta me rreth 248% dhe të ardhurat për banor me rreth 395%; detyrimet e prapambetura ranë me rreth 76% dhe aparati administrativ u tkurr me rreth 38%, duke e zhvendosur peshën e buxhetit nga pagat drejt shërbimeve e investimeve. Sipas Sistemit të Matjes së Performancës, shërbimet e transferuara janë sot 4,5–6,5 herë më të mira se më 2015. Ky projektligj nuk e mohon atë reformë — ai ndërton mbi të.

Njëkohësisht, baza demografike, ekonomike dhe fiskale mbi të cilën u ndërtua harta e vitit 2014 ka ndryshuar rrënjësisht. Censi i vitit 2023 regjistroi 2.402.113 banorë, 15,2% më pak se më 2011; mosha mesatare u rrit nga 35,3 në 42,5 vjeç dhe raporti i varësisë së të moshuarve gati u dyfishua. Gati gjysma e popullsisë jeton sot në shtatë bashki, ndërsa zonat malore plaken e zbrazen. Asimetria fiskale është po aq e thellë: 47 bashki gjenerojnë secila nën 1% të të ardhurave të veta vendore të vendit, ndërsa vetëm Tirana realizon rreth 39% të tyre. Bashkitë nën 10 mijë banorë mbajnë mesatarisht rreth 26 punonjës aparati për 1.000 banorë, kundrejt rreth 13 te bashkitë e mëdha — dyfish kosto fikse për të njëjtin shërbim.

Përfundimi i diagnozës është i qartë dhe i matur njëherazi: reforma e parë funksionoi, por korniza territoriale e saj në një pjesë të territorit nuk i përgjigjet më realitetit. Nevojitet një përditësim i bazuar në evidencë — më pak bashki aty ku e kërkon evidenca — jo një përmbysje e modelit.

A.4 Baza e evidencës: Raporti Përfundimtar i Komisionit të Posaçëm (RAT 2.0)

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale, i ngritur me vendimin nr. 75/2025 të Kuvendit, punoi me një grup të gjerë ekspertësh të pushtetit vendor, financave publike vendore, zhvillimit ekonomik, shërbimeve dhe qeverisjes vendore. Baza empirike e Raportit të tij Përfundimtar përfshin të dhënat financiare të Ministrisë së Financave për periudhën 2013–2025, Censin 2023, të dhënat e INSTAT-it dhe AMVV-së, Sistemin e Matjes së Performancës dhe një matricë prej 1.865 itineraresh rrugore të matura mbi rrjetin real. Vlerësimi ndoqi parimin "diagnostikimi para konsolidimit": çdo analizë nis nga 61 bashkitë ekzistuese kundrejt pragjeve minimale, dhe vetëm aty ku diagnoza evidenton mungesë të qëndrueshme mase kritike shqyrtohet konsolidimi si zgjidhje.

Ky raport shoqërues i referohet Raportit të Komisionit si burim i verifikueshëm për çdo tregues të cituar; tabelat e plota për 28 bashkitë e përfshira jepen në Aneksin A, ndërsa metodologjia e indekseve përmblidhet në Aneksin E.

A.5 Metodologjia e vlerësimit: tre indekse dhe dy kritere

Territori u vlerësua me një kornizë shumëdimensionale prej tre indeksesh të përbëra dhe dy kriteresh plotësuese, secili i ankoruar në standarde europiane (Karta Europiane e Autonomisë Vendore, TFEU, OECD):

- IFB – Indeksi i Funksionalitetit të Bashkive: mat kapacitetin fiskal e organizativ përmes pesë treguesve – autonomia fiskale (27%), ngurtësia buxhetore (21%), mbulimi funksional i ponderuar (22%), efiçenca e stafit (15%) dhe detyrimet e prapambetura (15%). Gjetja qendrore: më shumë se gjysma e bashkive nën nivelin e mesëm; njësitë e vogla shfaqin "sindromë institucionale" me autonomi rreth 4 herë më të ulët dhe aparat mbi trefish më të rëndë.
- IPE – Indeksi i Performancës Ekonomike: mat bazën ekonomike përmes vitalitetit të biznesit (20%), punësimit formal (20%), produktivitetit (25%), pagës mesatare (20%) dhe diversifikimit sektorial (15%). Gjetja qendrore: 38 nga 60 bashki me performancë të ulët.
- IMU – Indeksi i Masës Urbane: mat strukturën demografike-urbane mbi Censin 2023 përmes normës së urbanizimit (DEGURBA), dendësisë së perceptuar, madhësisë së popullsisë, kompaktësisë dhe raportit të varësisë. Gjetja qendrore: gjysma e bashkive në nivel të ulët, me vetëm 14,2% të popullsisë; 25 bashki pa asnjë qendër urbane.
- Distanca dhe graviteti urban: koha e udhëtimit e çdo njësie drejt "njësisë ankoruese" – qendrës më të afërt me masë urbane më të lartë. Gjysma e bashkive e arrijnë ankoren brenda 30 minutash; vetëm tri e tejkalojnë një orë.
- Kohezioni social-kulturor, historik dhe pakicat: ngjashmëria e komunitetit dhe garancitë për pakicat, mbi Konventën Kuadër të Këshillit të Europës, ligjin nr. 96/2017 dhe dëgjesat publike. Vepron si kriter "veto" kur preken të drejta themelore ose identitare, dhe si pikë vlerësimi për çdo rast tjetër.

Të tre indekset ndjekin të njëjtën procedurë statistikore: çdo tregues standardizohet me z-score mbi 60 bashki (Tirana mbahet jashtë referencës, pasi përmasat e saj do të deformonin shkallën) dhe rishkallëzohet 0–100, me tri nivele: i lartë, i mesëm, i ulët.

A.6 Parimet e vendimmarrjes për përzgjedhjen e rasteve

Përzgjedhja e njësive që konsolidohen u udhëhoq nga pesë parime të qëndrueshme, të zbatuara njësoj për çdo njësi:

- Diagnostikimi para konsolidimit: kandidate për konsolidim janë vetëm njësitë me tregues nën pragjet minimale të kapacitetit (IFB, IPE, IMU), pra pa masën kritike demografike e ekonomike për të ekzistuar realisht si njësi vetëqeverisëse.
- Ankorimi natyral: konsolidimi kryhet vetëm me qendrën drejt së cilës territori graviton realisht, brenda një kohe të arsyeshme udhëtimi sipas matricës së distancave.
- Ankorimi historik: konsolidimi kryhet gjithmonë brenda hapësirave të lidhura historikisht – në trembëdhjetë nga pesëmbëdhjetë rastet, brenda ish-rrethit të përbashkët; në dy rastet e tjera (Poliçan, Libohovë) brenda zonës së dokumentuar të gravitetit dhe të traditës.
- Mbrojtja e rasteve të veçanta: njësitë me veçori të theksuara identitare, kulturore, historike ose minoritare (p.sh. Pustec, Finiq, Dropull), si dhe ato tepër të largëta për t'u lidhur natyrshëm me një qendër tjetër (p.sh. Tropojë, Has, Himarë, mbi një orë udhëtim), ruhen të paprekura pavarësisht treguesve.

- Kriteret kufizuese: distanca dhe kohezioni veprojnë si kufij ndaj argumentit financiar-ekonomik — një konsolidim që përmirëson financat, por largon shërbimin nga qytetari ose cenon identitetin e komunitetit, nuk propozohet.

A.7 Objekti i projektligjit: 13 konsolidimet e propozuara

Në thelb, projektligji konsolidon 28 bashki ekzistuese në 13 bashki: 15 njësi pa masë kritike konsolidohen me 13 bashki qendër, në 13 njësi të reja të vetëqeverisjes vendore. Tabela paraqet 13 konsolidimet; për konsolidimet trepalëshe (Berat dhe Elbasan) jepen distancat e secilës njësi nga qendra e re.

Nr.	Bashkitë që konsolidohen	Qendra e re	Popullsia 2023 e konsoliduar	Distanca (km)	Koha (min)	Dosja
1	Fushë-Arrëz + Pukë	Pukë	11.100	20,6	35,9	B.1
2	Klos + Mat	Mat	29.577	17,8	23,2	B.2
3	Rrogozhinë + Kavajë	Kavajë	42.579	17,9	22,8	B.3
4	Berat + Dimal + Poliçan	Berat	99.129	Dimal 20,0; Poliçan 23,1	Dimal 37,4; Poliçan 38,7	B.4
5	Patos + Fier	Fier	120.190	7,4	13,4	B.5
6	Divjakë + Lushnjë	Lushnjë	88.017	20,2	32,6	B.6
7	Selenicë + Vlorë	Vlorë	93.263	27,6	38,9	B.7
8	Maliq + Korçë	Korçë	91.762	12,8	19,2	B.8
9	Këlcyrë + Përmet	Përmet	12.380	18,4	23,5	B.9
10	Memaliaj + Tepelenë	Tepelenë	13.339	8,4	12,3	B.10
11	Libohovë + Gjirokastër	Gjirokastër	26.035	20,7	31	B.11
12	Elbasan + Cërrik + Belsh	Elbasan	157.387	Cërrik 21,4; Belsh 30,2	Cërrik 30,2; Belsh 40,4	B.12
13	Prrenjas + Librazhd	Librazhd	42.080	28,8	38,1	B.13

Distancat dhe kohët e udhëtimit qendër–qendër sipas matricës së itinerareve rrugore (2026), mbi itinerarin kryesor rrugor; detajet për 15 çiftet qendër–qendër jepen në Aneksin B.

Pas riorganizimit, numri i bashkive zbret nga 61 në 46 — numër që plotësohet në nenin 1, pika 1, shkronja "a", të projektligjit. Dy konsolidime janë trepalëshe dhe trajtohen secili në një dosje të vetme: bashkia e konsoliduar Berat përfshin territoret e Beratit, Dimalit dhe Poliçanit (99.129 banorë, tre qytete përbërëse — dosja B.4), ndërsa bashkia e konsoliduar Elbasan përfshin territoret e Elbasanit, Cërrikut dhe Belshit (157.387 banorë, tre qytete përbërëse — dosja B.12). Të gjitha njësitë administrative ekzistuese ruhen të plota brenda bashkive të reja, me emërtimet dhe simbolet e tyre.

Trembëdhjetë konsolidimet përfshijnë gjithsej 28 bashki — 15 njësi që konsolidohen dhe 13 bashki qendër — me rreth 225 mijë banorë në njësitë që konsolidohen, dhe krijojnë bashki me popullsi nga rreth 11 mijë (Pukë–Fushë-Arrëz) deri në rreth 157 mijë banorë (Elbasani i konsoliduar).

A.8 Struktura e re e organizimit të brendshëm: Bashki → Qytet → Njësi Administrative

Krahas hartës së re, projektligji sanksionon në nenin 1, pika 2, një strukturë të re të organizimit të brendshëm të bashkisë: "Bashkia si njësia bazë e qeverisjes vendore përbëhet nga qytetet. Qytetet përbëhen nga njësitë administrative dhe/ose fshatrat dhe kanë status të veçantë ligjor që rregullohet me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Organizimi dhe përfaqësimi i bashkisë mbështeten në parimin e përfaqësimit proporcional të qyteteve përbërëse, sipas peshës së tyre në popullsinë e bashkisë."

Qyteti është njësi funksionale, planifikimi dhe përfaqësimi — jo person juridik, pa buxhet dhe pa institucione të veçanta. Bashkia mbetet e vetmja njësi e vetëqeverisjes vendore: një kryetar, një këshill, një administratë, një buxhet. Kryetari i bashkisë emëron një nënkryetar për çdo qytet, përgjegjës për koordinimin administrativ dhe funksionimin e shërbimeve në atë territor; qyteti shërben njëkohësisht si bazë territoriale për ndarjen proporcionale të mandateve në këshillin bashkiak. Në këtë mënyrë forcohet prania e bashkisë në territor dhe garantohet zëri i çdo komuniteti, pa krijuar nivel të ri pushteti dhe pa kosto shtesë administrative.

Modeli zbatohet njësoj në dy situata: në bashkitë e bashkuara, njësitë që konsolidohen vijojnë si qytete përbërëse me njësitë e veta administrative (p.sh. Elbasan + Cërrik + Belsh = tre qytete); në bashkitë me kufij të pandryshuar, qytetet njihen brenda territorit aktual sipas gravitetit natyror (p.sh. Dibra me qytetet Peshkopi, Kastriot e Maqellarë; Shkodra me qytetet Shkodër, Dukagjin e Velipojë). Kriteret e formimit të qyteteve janë: pragu demografik, graviteti i njësive administrative (koha e udhëtimit), vazhdimësia territoriale, identiteti historik dhe përkatësia unike e çdo njësie administrative te një qytet i vetëm.

Harta e re kombëtare e organizimit të brendshëm përfshin 46 bashki, 71 qytete dhe 387 njësi administrative; 20 bashki kanë më shumë se një qytet. Lista e plotë e qyteteve që krijohen, sipas bashkive respektive (në kllapa numri i njësive administrative; me yll bashkitë e konsoliduara të Pjesës B):

Qarku	Bashkia	Qytetet përbërëse (nr. NjA)
Berat	Berat *	Berat (5); Dimal (4); Poliçan (3)
	Kuçovë	Kuçovë (4)
	Skrapar	Skrapar (9)
Dibër	Dibër	Peshkopi (7); Kastriot (7); Maqellarë (1)
	Bulqizë	Bulqizë (6); Shupenzë (2)
	Mat *	Burrel (8); Klos (4)
Durrës	Durrës	Durrës (6)

Qarku	Bashkia	Qytetet përbërëse (nr. NjA)
	Shijak	Shijak (4)
	Krujë	Krujë (3); Fushë-Krujë (3)
Elbasan	Elbasan *	Elbasan (13); Cërrik (5); Belsh (5)
	Peqin	Peqin (6)
	Gramsh	Gramsh (10)
	Librazhd *	Librazhd (7); Prrenjas (4)
Fier	Fier *	Fier (10); Patos (3)
	Roskovec	Roskovec (4)
	Lushnje *	Lushnjë (11); Divjakë (5)
	Mallakastër	Ballsh (9)
Gjirokastër	Gjirokastër *	Gjirokastër (7); Libohovë (3)
	Tepelenë *	Tepelenë (4); Memaliaj (6)
	Përmet *	Përmet (5); Këlcyrë (4)
	Dropull	Dropull (3)
Korçë	Korçë *	Korçë (8); Maliq (7)
	Pustec	Pustec (1)
	Kolonjë	Ersekë (8)
	Devoll	Bilisht (5)
	Pogradec	Pogradec (8)
Kukës	Kukës	Kukës (15)
	Has	Has (4)
	Tropojë	Tropojë (8)
Lezhë	Lezhë	Lezhë (9); Shëngjin (1)

Qarku	Bashkia	Qytetet përbërëse (nr. NjA)
	Mirditë	Rrëshen (6); Rubik (1)
	Kurbin	Kurbin (3); Mamurras (1)
Shkodër	Malësi e Madhe	Koplik (6)
	Shkodër	Shkodër (7); Dukagjin (4); Velipojë (1)
	Vau-Dejës	Vau-Dejës (6)
	Pukë *	Pukë (5); Fushë-Arrëz (5)
Tiranë	Tiranë	Tiranë (28)
	Kamëz	Kamëz (2)
	Vorë	Vorë (3)
	Kavajë *	Kavajë (5); Rrogozhinë (5)
Vlorë	Vlorë *	Vlorë (4); Orikum (1); Selenicë (6)
	Himarë	Himarë (3)
	Sarandë	Sarandë (2)
	Konispol	Konispol (3)
	Finiq	Finiq (5)
	Delvinë	Delvinë (2)

Tabela A.8. Ndarja e re e brendshme sipas "Riorganizime_Finale" dhe dokumentit përmbledhës të ndarjes administrativo-territoriale (totalet sipas qarqeve: Berat 3/5/25, Dibër 3/7/35, Durrës 3/4/16, Elbasan 4/7/50, Fier 4/6/42, Gjirokastër 4/7/32, Korçë 5/6/37, Kukës 3/3/27, Lezhë 3/6/21, Shkodër 4/7/33, Tiranë 4/5/43, Vlorë 6/8/26). Tabela e plotë me njësitë administrative të secilit qytet jepet në Aneksin D.

A.9 Mendimi i popullatës: kuadri i përgjithshëm i konsultimit

Kushtetuta e kushtëzon ndryshimin e kufijve vendorë me marrjen paraprake të mendimit të popullsisë që banon në to. Ky raport e trajton këtë detyrim në dy shtresa. Shtresa e parë është konsultimi diagnostik i kryer nga Komisioni i Posaçëm: njëmbëdhjetë dëgjesa publike rajonale (prill–qershor 2026), me pjesëmarrjen e mbi 3.500 qytetarëve e përfaqësuesve, të dokumentuara sipas një metodologjie të unifikuar dhe të agreguara në raportin përmbledhës kombëtar. Dëgjesat konvergjuan në pesë mesazhe: afërsia e shërbimit si kriter mbizotërues; njësitë administrative si hallka e domosdoshme por e dobët;

mospërputhja funksione–kompetenca–burime; formula e financimit dhe kostoja reale e territorit, përfshirë rentën e burimeve natyrore; dhe llogaridhënia e konsultimi me ndikim të matshëm.

Shtresa e dytë është procesi i posaçëm i marrjes së mendimit të popullsisë për secilën njësi që riorganizohet, në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 139/2015, i cili do të zhvillohet përpara miratimit të ligjit: dëgjesa publike të strukturuara në çdo njësi të përfshirë (përfshirë njësitë administrative periferike), pyetësorë të dokumentuar dhe shqyrtim në këshillat bashkiakë përkatës, me dokumentim publik të rezultateve. Sipas vendimit nr. 19/2015 të Gjykatës Kushtetuese, marrja e mendimit është detyrim kushtetues, por nuk barazohet domosdoshmërisht me marrjen e pëlqimit dhe nuk kërkon referendum; ajo duhet të jetë paraprake, reale dhe e dokumentuar. Rezultatet integrohen në seksionin X.7 të secilës dosje përpara shqyrtimit përfundimtar në seancë plenare. Për Qarkun Tiranë, ku nuk u zhvillua dëgjesë rajonale në fazën diagnostike, procesi i posaçëm merr rëndësi të shtuar.

Në përputhje me Relacionin shpjegues të projektligjit, pas regjistrimit të nismës në Kuvend, projektligji u dërgohet për mendim zyrtar organeve vendore të përfshira drejtpërdrejt në riorganizim (këshillave bashkiakë e të qarqeve dhe kryetarëve, sipas nenit 90 të ligjit nr. 139/2015), Ministrisë së Financave (për rregullimin e çështjeve financiare, pasurore dhe të detyrimeve), institucioneve të pavarura kushtetuese (Avokati i Popullit, KLSH, Komisioneri për Shërbimin Civil, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) dhe Këshillit të Ministrave; mendimi i popullsisë së prekur, i marrë nga organet vendore, i përcillet Kuvendit.

Gjetjet e dëgjesave lexohen me statusin e tyre të saktë të evidencës: ato pasqyrojnë perceptime dhe prioritete të artikuluara në sallë, jo fakte të verifikuara statistikisht, dhe plotësojnë — nuk zëvendësojnë — analizën teknike.

A.10 Përfitimet e pritshme në nivel kombëtar

Në nivel kombëtar, zbatimi i trembëdhjetë konsolidimeve pritet të sjellë pesë grupe përfitimesh. Së pari, efikasitet fiskal: eliminimi i pesëmbëdhjetë aparateve administrative paralele në territore pa masë kritike, ku kostoja fikse arrin deri në dyfishin e mesatares për banor, çliron burime që rialokohen drejt shërbimeve e investimeve. Së dyti, standard më i barabartë shërbimesh: njësitë e reja kanë masën minimale për të ushtruar realisht funksionet që sot mbeten formale — nga planifikimi territorial te shërbimet sociale — duke e afruar territorin me parimin që cilësia e shërbimit të varet nga e drejta e qytetarit, jo nga vendbanimi i tij. Së treti, gatishmëri për integrimin europian: rreth 70% e legjislacionit të BE-së zbatohet në nivel vendor, dhe njësi më të mëdha e më të afta janë kusht për përthithjen e fondeve IPA dhe, në perspektivë, të fondeve të kohezionit. Së katërti, qëndrueshmëri demografike-ekonomike: ankorimi i territoreve në tkurrje te qendrat me kapacitet real u jep atyre qasje në tregje, shërbime dhe investime që të vetme nuk i gjenerojnë dot. Së pesti, demokraci vendore më e fortë: struktura Bashki–Qytet–Njësi Administrative dhe përfaqësimi proporcional i qyteteve garantojnë që konsolidimi të mos shoqërohet me humbje të zërit të komuniteteve, por me institucionalizimin e tij.

Ky projektligj zbaton shtyllën e parë (harta territoriale) të drejtimit katërshtyllësh të rekomanduar nga Raporti RAT 2.0 — harta, funksionet, financimi dhe niveli rajonal — dhe krijon parakushtet territoriale për tri shtyllat e tjera, të cilat kërkojnë ndërhyrje ligjore të veçanta.

PJESA B — DOSJET E TREMBËDHJETË KONSOLIDIMEVE

Secila dosje është e vetëmjaftueshme dhe ndjek të njëjtën strukturë dymbëdhjetëseksionëshe, të lidhur shprehimisht me kriteret e nenit 108, pika 2, të Kushtetutës dhe të nenit 89 të ligjit nr. 139/2015. Treguesit numerikë burojnë nga sistemi i indekseve i Komisionit (2025), Censi 2023, të dhënat fiskale 2025 dhe matrica e distancave (2026); tabelat e plota jepen në Aneksin A.

B.1 Konsolidimi i bashkive Fushë-Arrëz dhe Pukë në Bashkinë Pukë

B.1.1 Përmbledhja e rastit

Propozohet që Bashkia Fushë-Arrëz të konsolidohet me Bashkinë Pukë, duke krijuar një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore me qendër në Pukë, me 11.100 banorë (Censi 2023), sipërfaqe rreth 1.046 km² dhe 10 njësi administrative. Qendrat e dy njësive ndajnë 20,6 km rrugë dhe rreth 35,9 minuta udhëtim.

Treguesi	Fushë-Arrëz	Pukë	Njësia e konsoliduar	Referenca
Popullsia (Censi 2023)	4.878	6.222	11.100	INSTAT
Sipërfaqja (km²)	540,4	505,5	1045,9	Ligji 115/2014
IFB (0–100 / niveli / renditja)	34,2 / i ulët / 57	44,2 / i ulët / 49	—	Indeksi IFB 2025
IPE (0–100 / niveli / renditja)	27,1 / i ulët / 51	40 / i ulët / 34	—	Indeksi IPE 2025
IMU (0–100 / niveli / renditja)	25,1 / i ulët / 43	22,9 / i ulët / 49	—	Indeksi IMU 2025
Të ardhura të veta 2025 (mijë lekë)	36.230	33.252	69.482	MFE 2025
Të ardhura të veta / banor (lekë)	7.427	5.344	6.260	Llogaritje
Njësi administrative	—	—	10	Projektligji
Koha e udhëtimit qendër–qendër	—	—	35,9 min (20,6 km)	Matrica 2026

Konsolidimi Fushë-Arrëz–Pukë rikompozon një hapësirë historikisht dhe funksionalisht të njësuar, që reforma e vitit 2014 e la të ndarë në dy njësi pa masë kritike. Të dy treguesit strukturorë (IFB dhe IMU në nivel të ulët për të dyja njësitë) dhe distanca e shkurtër reciproke e bëjnë këtë rast një nga konsolidimet më të qarta të propozimit.

Statusi i qytetit përbërës: në zbatim të nenit 1, pika 2, të projektligjit, Fushë-Arrëz njihet brenda bashkisë së re si qytet përbërës, me njësitë e veta administrative, me nënkryetar të emëruar nga kryetari i bashkisë dhe me përfaqësim proporcional në këshillin bashkiak sipas peshës së vet demografike (rreth 43,9% e popullsisë së bashkisë përfundimtare).

B.1.2 Profili i njësive të përfshira

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet në pjesën lindore të Qarkut Shkodër, në zonën malore të Pukës dhe të Dukagjinit të poshtëm, dhe përbëhet nga qyteti i Fushë-Arrëzit dhe njësitë administrative Fierzë, Blerim, Qafë-Mali dhe Iballë. Qyteti u zhvillua në gjysmën e dytë të shekullit XX si qendër e industrisë së drurit dhe e minierave të bakrit, në kryqëzimin e akseve rrugore drejt Pukës, Fierzës dhe Kukësit.

Bashkia Pukë, me qendër qytetin e Pukës, përfshin njësitë administrative Pukë, Gjegjan, Rrapë, Qelëz dhe Qerret. Puka është qendra tradicionale administrative, tregtare dhe kulturore e krahinës që nga periudha osmane dhe, deri në reformën e vitit 2014, qendër e rrethit të Pukës, në të cilin bënte pjesë edhe territori i sotëm i Fushë-Arrëzit.

Njësitë administrative sipas ligjit nr. 115/2014: Bashkia Fushë-Arrëz — Fushë-Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali, Iballë; Bashkia Pukë — Pukë, Gjegjan, Rrapë, Qelëz, Qerret.

B.1.3 Nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomikë; tradita historike [Kriteri 1 — neni 108/2 i Kushtetutës]

Dy bashkitë kanë qenë historikisht një trup i vetëm administrativ: rrethi i Pukës. Krahina e Pukës përbën një hapësirë të njësuar etnografike e kulturore, me lidhje të dendura familjare, ekonomike e tregtare mes qytetit të Pukës dhe Fushë-Arrëzit, të cilat vijnë natyrshëm përgjatë aksit rrugor kombëtar që i lidh të dyja qendrat. Ndarja e vitit 2014 në dy bashki krijoi dy njësi të vogla paralele mbi të njëjtin territor funksional, secila pa masën kritike demografike e fiskale.

Interesat e përbashkët ekonomikë janë të prekshëm: administrimi i fondit pyjor e kullosor që shtrihet pa ndërprerje mbi të dy territoret, potenciali hidroenergjetik dhe minerar i zonës (bakri i Fushë-Arrëzit dhe i Gjegjanit), tregu i përbashkët i punës dhe i shërbimeve, si dhe zhvillimi i turizmit malor rreth liqenit të Fierzës dhe alpeve të Pukës. Asnjë prej këtyre burimeve nuk administrohet dot në mënyrë efikase nga dy administrata të ndara me nga pak mijëra banorë secila.

B.1.4 Arsyet e riorganizimit sipas pesë dimensioneve [Kriteri 2 — neni 89, shkronja "a"]

Arsyet ekonomike. Të dyja njësitë operojnë mbi bazë ekonomike të pamjaftueshme: ekonomia lokale mbetet e varur nga pylltaria, nga disa aktivitete minerare dhe nga punësimi publik, me vitalitet të ulët biznesi dhe diversifikim minimal. Treguesit: IPE 27,1 (i ulët, renditja 51/61) për Fushë-Arrëz, kundrejt 40,0 (i ulët) për Pukë; 17,0 biznese/1.000 banorë kundrejt 36,0; të ardhura të veta 7.427 lekë/banor kundrejt 5.344 lekë/banor.

Arsyet sociale. Shërbimet sociale, arsimore dhe shëndetësore parësore janë të fragmentuara mes dy administratave të vogla; asnjëra nuk ofron dot standardin minimal të plotë të shërbimeve, ndërsa banorët i marrin tashmë një pjesë të shërbimeve spitalore, arsimore të mesme dhe administrative në Pukë ose në Shkodër.

Arsyet kulturore. Konsolidimi rikthen njësinë kulturore të krahinës së Pukës, pa cenuar asnjë veçori identitare: të dy komunitetet i përkasin së njëjtës trashëgimi krahinore dhe fetare, me tradita të përbashkëta.

Arsyet demografike. Rënia demografike është ndër më të thellat në vend: territori i dy bashkive së bashku ka sot rreth 11.100 banorë, me plakje të theksuar dhe largim të vazhdueshëm të të rinjve. Treguesit: IMU 25,1 (i ulët, renditja 43/61) për Fushë-Arrëz, kundrejt 22,9 (i ulët) për Pukë.

Arsyet administrative. Të dyja bashkitë shfaqin "sindromën institucionale" të njësive të vogla: aparat i rëndë për banor, autonomi fiskale minimale dhe pamundësi për të mbajtur staf të specializuar (inxhinierë, planifikues, financierë, specialistë prokurimesh). Treguesit: IFB 34,2 (i ulët, renditja 57/61) për Fushë-Arrëz; autonomi fiskale 14,1% kundrejt 10,8% të Pukë-së; 17,2 punonjës aparati/1.000 banorë kundrejt 14,6.

Avantazhet e riorganizimit:

- Krijimi i një njësie me rreth 11.100 banorë dhe 1.046 km², me masë të mjaftueshme për një administratë të vetme profesionale në vend të dy aparateve paralele.
- Administrim i njësuar i fondit pyjor, i burimeve minerare dhe i potencialit turistik të krahinës.
- Ulje e kostos fikse administrative dhe rialokimi i kursimeve drejt shërbimeve e investimeve.
- Përfaqësim më i fortë i krahinës së Pukës në raport me qeverinë qendrore, qarkun dhe programet e zhvillimit rajonal.

B.1.5 Distanca dhe graviteti urban [Kriteri plotësues i vlerësimit]

Qendra e re, qyteti i Pukës, ndodhet 20,6 km dhe rreth 36 minuta udhëtim nga Fushë-Arrëzi, përgjatë rrugës kombëtare. Sipas matricës së distancave të Komisionit, Puka dhe Fushë-Arrëzi janë reciprokisht njësitë më të afërta me masë urbane, çka e bën këtë çift ankorimin e vetëm natyral brenda krahinës: alternativa e ankorimit në Vau të Dejës ose në Shkodër do të kërkonte mbi 90 minuta udhëtim.

Vëmendje e posaçme i kushtohet njësisë administrative Iballë, njësia më e izoluar në vend sipas matricës së distancave (mbi 3 orë udhëtim nga qendra më e afërt bashkiake e matur). Për Iballën dhe Blerimin parashikohen sportele shërbimi me funksione të zgjeruara, shërbime të lëvizshme periodike dhe investim prioritar në rrugën lidhëse.

Për ruajtjen e afërsisë së shërbimit, në qendrën e njësisë që konsolidohet dhe në çdo njësi administrative funksionon sportel i integruar shërbimesh me standard të përcaktuar; për njësitë periferike parashikohen shërbime të lëvizshme periodike dhe orare të garantuara transporti publik drejt qendrës së re.

B.1.6 Kohezioni social-kulturor, identiteti dhe pakicat [Kriteri "veto"]

Konsolidimi kryhet tërësisht brenda hapësirës historike të krahinës së Pukës dhe nuk prek asnjë komunitet pakice të njohur me ligjin nr. 96/2017. Në dëgjesën publike të Qarkut Shkodër nuk u evidentuan kundërshti identitare për këtë territor; kriteri i kohezionit nuk aktivizohet si kriter ndalues.

Garancitë identitare të zbatueshme për këtë rast: ish-bashkia Fushë-Arrëz vijon si njësi administrative me emërtimin e saj; ruhen simbolet, emërtimet historike dhe festat lokale; komunitetit i garantohet përfaqësim në strukturat konsultative të bashkisë së re dhe zbatohen mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje për njësitë administrative.

B.1.7 Mendimi i popullatës [Kriteri 3 — neni 108/2; neni 89, shkronja "b"]

Në dëgjesën publike të Qarkut Shkodër (15 maj 2026), ku u referuan të pesta bashkitë e qarkut përfshirë Pukën dhe Fushë-Arrëzin, kërkesat kryesore ishin njohja e kostos reale të territorit malor në formulën e financimit, kthimi i rentës së burimeve natyrore në territoret prodhuese dhe forcimi i njësive administrative si hallka më e afërt me komunitetin.

Në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 139/2015, përpara miratimit të ligjit zhvillohet procesi i posaçëm i marrjes së mendimit të popullsisë për këtë rast: dëgjesa publike të strukturuara në qendrën e secilës njësi dhe në njësitë administrative, pyetësor i dokumentuar dhe shqyrtim në këshillat bashkiakë të Fushë-Arrëz-s dhe Pukë-s, me dokumentim publik të rezultateve.

[Ky seksion plotësohet me rezultatet e procesit të posaçëm të konsultimit përpara shqyrtimit në seancë plenare.]

B.1.8 Harta administrativo-territoriale dhe organizimi i brendshëm [Kriteri 4 — neni 89, shkronja "c"]

Njësia e re shtrihet mbi territorin e plotë të dy bashkive ekzistuese, pa asnjë ndryshim të kufijve të jashtëm të tyre: kufiri i ri i bashkisë Pukë përbëhet nga konsolidimi i kufijve ekzistues të të dy njësive, ndërsa kufiri i brendshëm mes tyre shfuqizohet. Qendra e bashkisë së re është qyteti Pukë. Njësitë administrative përbërëse janë: Pukë, Gjegjan, Rrapë, Qelëz, Qerret, Fushë-Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali, Iballë (gjithsej 10).

[Harta e gjendjes aktuale dhe harta e propozuar për këtë rast paraqiten në Aneksin C — përgatiten mbi shtresat zyrtare të ASIG-ut përpara depozitimit.]

Organizimi i brendshëm i bashkisë së konsoliduar sipas strukturës Bashki → Qytet → Njësi Administrative:

Qyteti	Njësitë administrative përbërëse	Nr. NjA	Popullsia 2023	Pesha
Pukë	Pukë, Gjegjan, Rrapë, Qelëz, Qerret	5	6.222	56,1%
Fushë-Arrëz	Fushë-Arrëz, Fierzë, Blerim, Qafë-Mali, Iballë	5	4.878	43,9%

Tabela B.1.8. Struktura e brendshme e bashkisë së konsoliduar Pukë sipas "Riorganizime_Finale". Pesha llogaritet ndaj popullsisë së bashkisë së konsoliduar (11.100 banorë, Censi 2023); për qytetet që nuk përkojnë me ish-bashki më vete, popullsia e veçuar saktësohet me detajimin teknik të hartave.

B.1.9 Rregullimi financiar dhe i detyrimeve [Kriteri 5 — neni 89, shkronja "ç"]

Njësia e re është pasardhëse universale e të dy bashkive: ajo trashëgon me ligj të gjitha të drejtat, detyrimet, asetet, pasuritë dhe marrëdhëniet juridike të tyre, përfshirë detyrimet ndaj të tretëve (kreditorë, kontrata në zbatim, vendime gjyqësore) dhe detyrimet e ndërsjella, të cilat shuhen me konsolidim. Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit kryhet inventarizimi i plotë i aseteve, i detyrimeve dhe i kontratave të të dy njësive, i certifikuar nga Ministria e Financave; regjistrimi i pasurive në emër të njësisë së re kryhet pa taksa e tarifa.

Buxheti i vitit të parë të njësisë së re ndërtohet si konsolidim i dy buxheteve ekzistuese; transferta e pakushtëzuar llogaritet mbi treguesit e territorit të konsoliduar dhe, për periudhën e tranzicionit, garantohet që asnjë njësi të mos marrë më pak se shuma e transfertave aktuale të të dy njësive. Investimet në vijim vazhdojnë sipas kontratave; personeli trajtohet sipas legjislacionit të nëpunësit civil dhe Kodit të Punës, me plan ristrukturimi që jep përparësi rialokimit drejt shërbimeve dhe sporteleve territoriale.

Treguesi fiskal (2025)	Fushë-Arrëz	Pukë	Njësia e konsoliduar
Të ardhura të veta (mijë lekë)	36.230	33.252	69.482
Ndërmarrje aktive (2023)	83	224	307
Të punësuar në ndërmarrje	718	1.139	1.857

Treguesi fiskal (2025)	Fushë-Arrëz	Pukë	Njësia e konsoliduar
Barra e detyrimeve të prapambetura (% e buxhetit)	0%	2,1%	konsolidohet

B.1.10 Realizimi në nivel më të lartë i funksioneve dhe i politikave të zhvillimit [Kriteri 6]

Njësia e re do të mundësojë ushtrimin real të funksioneve që sot mbeten formale në të dyja bashkitë: planifikimi i territorit dhe menaxhimi i pyjeve mbi bazë krahinore, mbrojtja civile me një strukturë të vetme operacionale për zonën malore, menaxhimi i mbetjeve me një skemë të vetme, dhe përgatitja e projekteve për fondet kombëtare e europiane, për të cilat asnjëra nga dy njësitë aktuale nuk ka sot kapacitet teknik.

B.1.11 Përfitimet e pritshme dhe treguesit e monitorimit [Kriteri 7]

- Kursim i vlerësueshëm administrativ nga konsolidimi i dy aparateve (të dyja bashkitë operojnë sot me ngarkesë aparati ndër më të lartat për banor në vend).
- Një zyrë e vetme projektesh me kapacitet për të thithur fonde IPA/kombëtare për pyjet, turizmin malor dhe infrastrukturën.
- Standard i njësuar shërbimesh për të gjithë krahinën, me garanci aksesi për njësitë periferike.
- Tregues të pritshëm në rritje të IFB-së të njësisë së re kundrejt mesatares së ponderuar aktuale.

Zbatimi monitorohet me tregues të matshëm — IFB/IPE/IMU të njësisë së re, kosto administrative për banor, standardet e shërbimeve në njësitë administrative — me rivlerësim publik jo më vonë se tre vjet pas konstituimit të organeve të reja.

B.1.12 Konkluzioni: tabela e konformitetit

Kriteri	Vlerësimi	Referenca
1. Nevojat e interesat e përbashkët ekonomikë dhe tradita historike (neni 108/2)	Plotësohet	B.1.3
2. Arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative (neni 89/a)	Plotësohet	B.1.4
3. Mendimi i popullatës (neni 108/2; neni 89/b)	Në proces	B.1.7 — plotësohet para miratimit
4. Hartat administrativo-territoriale (neni 89/c)	Plotësohet	B.1.8; Anekset C–D
5. Rregullimi financiar dhe i detyrimeve (neni 89/ç)	Plotësohet	B.1.9

Kriteri	Vlerësimi	Referenca
6. Funksionet në nivel më të lartë / politikat e zhvillimit	Plotësohet	B.1.10
7. Përfitimet nga zbatimi i reformës	Plotësohet	B.1.11

B.2 Konsolidimi i bashkive Klos dhe Mat në Bashkinë Mat

B.2.1 Përmbledhja e rastit

Propozohet që Bashkia Klos të konsolidohet me Bashkinë Mat, duke krijuar një njësi të vetme të vetëqeverisjes vendore me qendër në Mat, me 29.577 banorë (Censi 2023), sipërfaqe rreth 851 km² dhe 12 njësi administrative. Qendrat e dy njësive ndajnë 17,8 km rrugë dhe rreth 23,2 minuta udhëtim.

Treguesi	Klos	Mat	Njësia e konsoliduar	Referenca
Popullsia (Censi 2023)	12.172	17.405	29.577	INSTAT
Sipërfaqja (km²)	357,5	493,5	851	Ligji 115/2014
IFB (0–100 / niveli / renditja)	47,5 / i mesëm / 46	54,3 / i mesëm / 34	—	Indeksi IFB 2025
IPE (0–100 / niveli / renditja)	33,4 / i ulët / 44	51,2 / i mesëm / 18	—	Indeksi IPE 2025
IMU (0–100 / niveli / renditja)	24,5 / i ulët / 45	50,9 / i mesëm / 24	—	Indeksi IMU 2025
Të ardhura të veta 2025 (mijë lekë)	37.054	112.486	149.540	MFE 2025
Të ardhura të veta / banor (lekë)	3.044	6.463	5.056	Llogaritje
Njësi administrative	—	—	12	Projektligji
Koha e udhëtimit qendër–qendër	—	—	23,2 min (17,8 km)	Matrica 2026

Konsolidimi Klos–Mat rikthen njësinë natyrore të krahinës së Matit: një luginë, një treg pune, një qendër graviteti (Burreli) dhe distanca më e shkurtër ndërbashkiake në qark. Evidenca strukturore dhe tradita historike konvergjojnë pa tension në të njëjtin përfundim.

Statusi i qytetit përbërës: në zbatim të nenit 1, pika 2, të projektligjit, Klos njihet brenda bashkisë së re si qytet përbërës, me njësitë e veta administrative, me nënkryetar të emëruar nga kryetari i bashkisë dhe me përfaqësim proporcional në këshillin bashkiak sipas peshës së vet demografike (rreth 41,2% e popullsisë së bashkisë përfundimtare).

B.2.2 Profili i njësive të përfshira

Bashkia Klos shtrihet në pjesën jugore të luginës së Matit, me qendër qytetin e Klosit dhe njësitë administrative Klos, Xibër, Suç dhe Gurrë. Deri më 2014 territori i saj ishte pjesë përbërëse e rrethit të Matit; qyteti u zhvillua si qendër agrare dhe minerare e luginës së sipërme të Matit.

Bashkia Mat, me qendër qytetin e Burrelit, përfshin njësitë administrative Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis dhe Ulëz. Burreli është qendra historike administrative e krahinës së Matit dhe ish-

qendra e rrethit të Matit, me profil agro-blegtoral, minerar dhe hidroenergjetik (kaskada e Ulzës dhe e Shkopetit).

Njësitë administrative sipas ligjit nr. 115/2014: Bashkia Klos — Klos, Xibër, Suç, Gurrë; Bashkia Mat — Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis, Ulëz.

B.2.3 Nevojat dhe interesat e përbashkët ekonomikë; tradita historike [Kriteri 1 — neni 108/2 i Kushtetutës]

Mati është një nga krahinat më të kristalizuara etnografike të Shqipërisë, me identitet të fortë historik e kulturor të dokumentuar prej shekujsh. Klosi dhe Burreli i përkasin të njëjtës luginë, të njëjtës krahinë dhe deri më 2014 të njëjtit rreth administrativ. Ndarja e krahinës në dy bashki nuk u mbështet në asnjë kufi natyror a funksional: lugina e Matit është një hapësirë e vetme gjeografike, ekonomike dhe kulturore.

Interesat e përbashkët përfshijnë administrimin e luginës së Matit si sistem i vetëm (ujërat, kaskada hidroenergjetike Ulëz–Shkopet, mbrojtja nga përmbytjet dhe erozioni), rrjetin e përbashkët rrugor drejt Rrugës së Arbrit — e cila e vendos krahinën në aksin e ri kombëtar Tiranë–Dibër — si dhe tregun e përbashkët të punës e të shërbimeve me qendër Burrelin.

B.2.4 Arsyet e riorganizimit sipas pesë dimensioneve [Kriteri 2 — neni 89, shkronja "a"]

Arsyet ekonomike. Klosi operon mbi bazë ekonomike të dobët, me pak ndërmarrje aktive dhe punësim formal të kufizuar, ndërsa Mati ka profil të mesëm me bazë më të gjerë shërbimesh e tregtie në Burrel. Treguesit: IPE 33,4 (i ulët, renditja 44/61) për Klos, kundrejt 51,2 (i mesëm) për Mat; 10,9 biznese/1.000 banorë kundrejt 31,1; të ardhura të veta 3.044 lekë/banor kundrejt 6.463 lekë/banor.

Arsyet sociale. Burreli ofron tashmë për banorët e Klosit një pjesë të shërbimeve arsimore të mesme, shëndetësore dhe administrative; konsolidimi e formalizon këtë marrëdhënie reale dhe mundëson standard të njësuar shërbimesh në të gjithë luginën.

Arsyet kulturore. Të dy komunitetet i përkasin të njëjtës krahinë etnografike të Matit, me tradita, folklor dhe kujtesë historike të përbashkët; konsolidimi e rikthen krahinën në një përfaqësim të vetëm institucional.

Arsyet demografike. Popullsia e përbashkët është rreth 29.600 banorë, me rënie të ndjeshme ndërmjet dy censeve dhe strukturë moshore në plakje; asnjëra njësi e marrë veçmas nuk e ndal dot këtë prirje me instrumentet e veta. Treguesit: IMU 24,5 (i ulët, renditja 45/61) për Klos, kundrejt 50,9 (i mesëm) për Mat.

Arsyet administrative. Klosi shfaq tregues të dobët funksionalë, me autonomi fiskale të ulët dhe mbulim të pjesshëm funksionesh, ndërsa edhe Mati mbetet nën pragjet e njësive me kapacitet të plotë; dy administrata paralele mbi një luginë të vetme dyfishojnë koston fikse pa dyfishuar shërbimin. Treguesit: IFB 47,5 (i mesëm, renditja 46/61) për Klos; autonomi fiskale 5,9% kundrejt 11,3% të Mat-së; 7,6 punonjës aparati/1.000 banorë kundrejt 6,4.

Avantazhet e riorganizimit:

- Rikompozimi i krahinës së Matit në një njësi të vetme me rreth 29.600 banorë dhe 851 km².
- Administrim i njësuar i luginës së Matit: ujërat, hidroenergjia, mbrojtja civile dhe territori.
- Pozicionim strategjik i njësuar përgjatë Rrugës së Arbrit dhe kapacitet për ta shfrytëzuar atë për zhvillim ekonomik.

- Ulje e kostos administrative dhe staf teknik i konsoliduar në një administratë të vetme.

B.2.5 Distanca dhe graviteti urban [Kriteri plotësues i vlerësimit]

Qendra e re, Burreli, ndodhet 17,8 km dhe rreth 23 minuta udhëtim nga Klosi, përgjatë rrugës së luginës që po përmirësohet ndjeshëm me segmentet e Rrugës së Arbrit. Sipas matricës së distancave, Mati është njësia ankoruese natyrale e Klosit — lidhja më e shkurtër ndërbashkiake në të gjithë Qarkun Dibër.

Për ruajtjen e afërsisë së shërbimit, në qendrën e njësisë që konsolidohet dhe në çdo njësi administrative funksionon sportel i integruar shërbimesh me standard të përcaktuar; për njësitë periferike parashikohen shërbime të lëvizshme periodike dhe orare të garantuara transporti publik drejt qendrës së re.

B.2.6 Kohezioni social-kulturor, identiteti dhe pakicat [Kriteri "veto"]

Konsolidimi kryhet brenda krahinës historike të Matit dhe nuk prek asnjë komunitet pakice. Çështja identitare e ngritur në dëgjesën e Qarkut Dibër (Golloborda) i përket territorit të Bashkisë Bulqizë dhe nuk lidhet me këtë konsolidim; kriteri i kohezionit nuk aktivizohet si kriter ndalues.

Garancitë identitare të zbatueshme për këtë rast: ish-bashkia Klos vijon si njësi administrative me emërtimin e saj; ruhen simbolet, emërtimet historike dhe festat lokale; komunitetit i garantohet përfaqësim në strukturat konsultative të bashkisë së re dhe zbatohen mekanizmat e buxhetimit me pjesëmarrje për njësitë administrative.

B.2.7 Mendimi i popullatës [Kriteri 3 — neni 108/2; neni 89, shkronja "b"]

Në dëgjesën publike të Qarkut Dibër (22 maj 2026), ku u referuan bashkitë Dibër, Bulqizë, Mat dhe Klos, u theksuan kostoja e territorit malor, nevoja e forcimit të njësive administrative dhe renta e burimeve natyrore; për luginën e Matit u evidentua rëndësia e Rrugës së Arbrit si shans zhvillimi që kërkon qeverisje të bashkërenduar.

Në zbatim të nenit 90 të ligjit nr. 139/2015, përpara miratimit të ligjit zhvillohet procesi i posaçëm i marrjes së mendimit të popullsisë për këtë rast: dëgjesa publike të strukturuara në qendrën e secilës njësi dhe në njësitë administrative, pyetësor i dokumentuar dhe shqyrtim në këshillat bashkiakë të Klos-s dhe Mat-s, me dokumentim publik të rezultateve.

[Ky seksion plotësohet me rezultatet e procesit të posaçëm të konsultimit përpara shqyrtimit në seancë plenare.]

B.2.8 Harta administrativo-territoriale dhe organizimi i brendshëm [Kriteri 4 — neni 89, shkronja "c"]

Njësia e re shtrihet mbi territorin e plotë të dy bashkive ekzistuese, pa asnjë ndryshim të kufijve të jashtëm të tyre: kufiri i ri i bashkisë Mat përbëhet nga konsolidimi i kufijve ekzistues të të dy njësive, ndërsa kufiri i brendshëm mes tyre shfuqizohet. Qendra e bashkisë së re është qyteti Mat. Njësitë administrative përbërëse janë: Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis, Ulëz, Klos, Xibër, Suç, Gurrë (gjithsej 12).

Organizimi i brendshëm i bashkisë së konsoliduar sipas strukturës Bashki → Qytet → Njësi Administrative:

Qyteti	Njësitë administrative përbërëse	Nr. NjA	Popullsia 2023	Pesha
Burrel	Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis, Ulëz	8	17.405	58,8%
Klos	Klos, Xibër, Suç, Gurrë	4	12.172	41,2%

Tabela B.2.8. Struktura e brendshme e bashkisë së konsoliduar Mat sipas "Riorganizime_Finale". Pesha llogaritet ndaj popullsisë së bashkisë së konsoliduar (29.577 banorë, Censi 2023); për qytetet që nuk përkojnë me ish-bashki më vete, popullsia e veçuar saktësohet me detajimin teknik të hartave.

B.2.9 Rregullimi financiar dhe i detyrimeve [Kriteri 5 — neni 89, shkronja "ç"]

Njësia e re është pasardhëse universale e të dy bashkive: ajo trashëgon me ligj të gjitha të drejtat, detyrimet, asetet, pasuritë dhe marrëdhëniet juridike të tyre, përfshirë detyrimet ndaj të tretëve (kreditorë, kontrata në zbatim, vendime gjyqësore) dhe detyrimet e ndërsjella, të cilat shuhen me konsolidim. Brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit kryhet inventarizimi i plotë i aseteve, i detyrimeve dhe i kontratave të të dy njësive, i certifikuar nga Ministria e Financave; regjistrimi i pasurive në emër të njësisë së re kryhet pa taksa e tarifa.

Buxheti i vitit të parë të njësisë së re ndërtohet si konsolidim i dy buxheteve ekzistuese; transferta e pakushtëzuar llogaritet mbi treguesit e territorit të konsoliduar dhe, për periudhën e tranzicionit, garantohet që asnjë njësi të mos marrë më pak se shuma e transfertave aktuale të të dy njësive. Investimet në vijim vazhdojnë sipas kontratave; personeli trajtohet sipas legjislacionit të nëpunësit civil dhe Kodit të Punës, me plan ristrukturimi që jep përparësi rialokimit drejt shërbimeve dhe sporteleve territoriale.

Treguesi fiskal (2025)	Klos	Mat	Njësia e konsoliduar
Të ardhura të veta (mijë lekë)	37.054	112.486	149.540
Ndërmarrje aktive (2023)	133	542	675
Të punësuar në ndërmarrje	575	3.357	3.932
Barra e detyrimeve të prapambetura (% e buxhetit)	8,9%	7,1%	konsolidohet

B.2.10 Realizimi në nivel më të lartë i funksioneve dhe i politikave të zhvillimit [Kriteri 6]

Njësia e re mundëson planifikim të njësuar territorial të luginës, menaxhim të integruar të ujërave dhe të rrezikut nga përmbytjet, strukturë të vetme të mbrojtjes civile, dhe një kapacitet real projektesh për të kapitalizuar Rrugën e Arbrit — funksione që sot ushtrohen pjesërisht ose aspak nga dy njësitë veçmas.

B.2.11 Përfitimet e pritshme dhe treguesit e monitorimit [Kriteri 7]

- Kursim administrativ nga konsolidimi i dy aparateve dhe rialokim drejt investimeve.
- Rritje e pritshme e treguesve funksionalë të njësisë së re kundrejt gjendjes aktuale të Klosit.

- Një zë i vetëm i krahinës së Matit në programet kombëtare të zhvillimit dhe në qarkun e Dibrës.
- Shërbime të standardizuara në të gjithë luginën, me sportele të plota në Klos dhe në njësitë rurale.

Zbatimi monitorohet me tregues të matshëm — IFB/IPE/IMU të njësisë së re, kosto administrative për banor, standardet e shërbimeve në njësitë administrative — me rivlerësim publik jo më vonë se tre vjet pas konstituimit të organeve të reja.

B.2.12 Konkluzioni: tabela e konformitetit

Kriteri	Vlerësimi	Referenca
1. Nevojat e interesat e përbashkët ekonomikë dhe tradita historike (neni 108/2)	Plotësohet	B.2.3
2. Arsyet ekonomike, sociale, kulturore, demografike, administrative (neni 89/a)	Plotësohet	B.2.4
3. Mendimi i popullatës (neni 108/2; neni 89/b)	Në proces	B.2.7 — plotësohet para miratimit
4. Hartat administrativo-territoriale (neni 89/c)	Plotësohet	B.2.8; Anekset C–D
5. Rregullimi financiar dhe i detyrimeve (neni 89/ç)	Plotësohet	B.2.9
6. Funksionet në nivel më të lartë / politikat e zhvillimit	Plotësohet	B.2.10
7. Përfitimet nga zbatimi i reformës	Plotësohet	B.2.11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Tiranë, më 30.07.2026

I nderuar zoti Kryetar / E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në emër të grupit të deputetëve propozues të mazhorancës parlamentare, anwtarw tw Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale më lejoni t'ju drejtohem me këtë letër për t'ju paraqitur propozimin për Reformën Administrativo-Territoriale 2.0 dhe për të kërkuar mendimin dhe kontributin tuaj institucional në procesin e konsultimit.

Të nderuar,

reforma administrativo-territoriale e vitit 2014 shënoi një ndryshim themelor në organizimin e pushtetit vendor në Shqipëri. Ajo i dha fund copëzimit të skajshëm të territorit, duke e kaluar vendin nga 373 njësi të qeverisjes vendore në 61 bashki më të mëdha dhe me më shumë mundësi për të ushtruar funksionet e tyre.

Dhjetë vjet më vonë, rezultatet e kësaj reforme janë të dukshme. Të ardhurat e veta të bashkive janë rritur ndjeshëm, detyrimet e prapambetura janë ulur, kapacitetet administrative janë forcuar dhe një pjesë më e madhe e buxheteve vendore është orientuar drejt investimeve dhe shërbimeve për qytetarët. Për herë të parë u ngrit gjithashtu një sistem kombëtar për matjen e performancës së bashkive.

Por pikërisht përvoja e këtyre dhjetë viteve ka nxjerrë në pah edhe sfida të reja. Reforma Administrativo-Territoriale 2.0 nuk është mohim i reformës së vitit 2014 dhe as kthim pas. Ajo është faza e dytë e të njëjtit proces reformues.

Shqipëria e vitit 2026 nuk është më Shqipëria e vitit 2014. Dinamikat demografike, ekonomike dhe territoriale kanë ndryshuar ndjeshëm, ndërsa zhvillimi ndërmjet bashkive mbetet i pabarabartë. Disa bashki kanë mundësi të investojnë, të tërheqin aktivitet ekonomik dhe të ofrojnë shërbime me standarde të larta, ndërsa të tjera përballen me tkurrjen e popullsisë aktive, me të ardhura të kufizuara dhe me mungesë të burimeve njerëzore të specializuara.

Në të njëjtën kohë, përparimi i Shqipërisë në procesin e integrimit europian vendos përpara pushtetit vendor kërkesa të reja. Rreth 70%e legjislacionit europian zbatohet në nivel vendor, në fusha si planifikimi, mjedisi, menaxhimi i mbetjeve, transporti, zhvillimi ekonomik lokal dhe shërbimet publike. Edhe përfitimi nga fondet e ardhshme të kohezionit dhe të zhvillimit rajonal kërkon bashki me kapacitete të forta administrative, teknike dhe financiare.

Përballë këtij realiteti, objektivat tona janë të qarta: bashki efikase dhe me kapacitete reale; bashki të afta të funksionojnë në hapësirën europiane; ruajtja e identitetit vendor; ekuilibri

ndërmjet efikasitetit dhe afërsisë me qytetarin; si dhe një zhvillim më i balancuar në të gjithë territorin.

Për të ndërtuar një reformë të mbështetur në fakte dhe në nevojat reale të territorit, Kuvendi ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale. Që në fillim zgjodhëm një model të pazakontë bashkëpunimi politik: bashkëdrejtimin e Komisionit dhe përfaqësimin e barabartë të mazhorancës dhe opozitës. Ky organizim u zgjodh sepse një reformë që prek organizimin e territorit dhe jetën e komuniteteve nuk duhet të jetë pronë e një pale politike apo e një mandati të vetëm.

Në kuadër të këtij procesi, Komisioni zhvilloi dëgjesa në 11 qarqe dhe dhjetëra takime me qytetarë, kryetarë bashkish, këshilltarë vendorë, përfaqësues të biznesit, universiteteve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Mbi 3,500 qytetarë morën pjesë në këto konsultime.

Ju shpreh mirënjohjen time të veçantë për kontributin që keni dhënë në këtë proces. Mendimet, shqetësimet dhe propozimet e drejtuesve vendorë kanë qenë thelbësore për të kuptuar më mirë problematikat e territorit dhe drejtimin që duhet të marrë reforma.

Nga konsultimet doli qartë se qytetarët nuk e shohin reformën thjesht si çështje kufijsh apo hartash administrative. Ata flasin për ujin, rrugën, shkollën, transportin, pastrimin, kujdesin social, kanalet vaditëse dhe cilësinë e shërbimeve. Qytetari nuk jeton në hartë; ai e përjeton pushtetin vendor përmes cilësisë së shërbimit që merr çdo ditë.

Pas përfundimit të mandatit të Komisionit, u gjendëm përpara një zgjedhjeje të qartë: ta linim pa rezultat një proces të nisur, ose ta vijonim atë me përgjegjësi, duke e kthyer dëgjimin, ekspertizën dhe analizën në një propozim konkret. Zgjodhëm të vazhdojmë, sepse Shqipëria nuk mund të humbasë kohë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe ndërtimit të bashkive europiane.

Propozimi që ju përcjellim është rezultat i analizës së dhjetë viteve të zbatimit të reformës së vitit 2014, i përvojës së krijuar gjatë kësaj periudhe, i dëgjesave publike dhe i punës së ekspertëve të Komisionit. Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni edhe raportin e detajuar analitik të përgatitur nga ekspertët, i cili paraqet të dhënat, gjetjet dhe argumentet mbi të cilat mbështetet propozimi.

Modeli i propozuar ruan bashkinë si të vetmen njësi të vetëqeverisjes vendore, me një kryetar, një këshill, një administratë dhe një buxhet të vetëm.

Organizimi i brendshëm propozohet të kalojë nga skema **Bashki – Njësi Administrative** në skemën **Bashki – Qytet – Njësi Administrative**. Qyteti do të shërbejë si njësi funksionale e planifikimit, përfaqësimit dhe organizimit të shërbimeve. Për çdo qytet propozohet caktimi i një nënkryetari përgjegjës për koordinimin administrativ dhe zbatimin e shërbimeve në territorin përkatës. Nuk krijohet një nivel i ri i pushtetit vendor dhe nuk shtohen struktura apo kosto administrative.

Këshilli bashkiak do të vazhdojë të jetë organi përfaqësues i bashkisë, por përbërja e tij do të pasqyrojë në mënyrë proporcionale peshën demografike të qyteteve përbërëse. Kryetari i bashkisë do të vazhdojë të zgjidhet drejtpërdrejt nga i gjithë trupi zgjedhor i bashkisë, duke ruajtur një ekzekutiv të unifikuar dhe një përgjegjësi të qartë politike.

Ky organizim synon të ruajë identitetin historik dhe qytetar të qyteteve, të forcojë përfaqësimin e tyre politik, të afrojë koordinimin e shërbimeve me komunitetin dhe të krijojë një nivel më të qartë territorial për planifikimin e zhvillimit dhe monitorimin e performancës.

Në përputhje me nenet 89 dhe 90 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ju kërkojmë:

1. Kryetari/ja i/e bashkisë të paraqesë mendimin e tij/saj zyrtar dhe të argumentuar mbi propozimin e bashkëlidhur;
2. Këshilli bashkiak ta shqyrtojë propozimin në mbledhje dhe të miratojë mendimin e tij zyrtar, duke pasqyruar në aktin përkatës edhe qëndrimet kundër ose alternative, nëse ka;
3. Bashkia të organizojë informimin dhe konsultimin e popullatës së territorit të saj, nëpërmjet dëgjesave publike në njësitë administrative, takimeve me banorët dhe instrumenteve të tjera të përshtatshme, si dhe të përmbledhë e të përcjellë zyrtarisht mendimin e popullatës.

Bashkëlidhur gjeni përmbledhjen e propozimit, hartat administrativo-territoriale dhe dokumentacionin argumentues përkatës.

Mendimet dhe dokumentacioni shoqërues lutemi të përcillen brenda 60 ditëve nga data e marrjes së kësaj shkrese, fizikisht ose në adresën elektronike te Kuvendit.

Teksa presim përgjigjen dhe kontributin tuaj, ju ftoj që këtë fazë ta trajtojmë me përgjegjësinë që kërkon një reformë shtetformuese. Reforma e vitit 2014 hodhi themelet për bashki më të forta dhe më funksionale. Sot kemi mundësinë që, së bashku, ta çojmë këtë proces një hap më tej dhe të ndërtojmë bashki europiane: me kapacitete më të mëdha, me përfaqësim më të mirë dhe më pranë qytetarit.

Me konsideratë,

ARBJAN MAZNIKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RELACION SHPJEGUES
PËR
PROJEKTLIGJIN

"PËR NDARJEN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ",

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nisma ligjore për miratimin e projektligjit "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore" ka për qëllim riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në fuqi, me ndryshim të kufijve ekzistues, në funksion të krijimit të një organizimi territorial më të qëndrueshëm, funksional, eficient dhe të përshtatur me zhvillimet demografike, ekonomike, sociale dhe administrative të vendit.

Riorganizimi i propozuar mbështetet në kriteret e përcaktuara në nenin 108, pika 2 të Kushtetutës si dhe nenin 86 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", dhe merr në konsideratë interesat ekonomikë dhe socialë të bashkësive vendore, traditën, kulturën, lidhjet tradicionale ndërmjet komuniteteve, identitetin dhe vlerat e tjera vendore. Nëpërmjet këtij riorganizimi, synohet që funksionet dhe kompetencat e vetëqeverisjes vendore të ushtrohen në një nivel më të lartë efektiviteti, eficience dhe cilësie, në përfitim të drejtpërdrejtë të banorëve dhe në mbështetje të politikave të zhvillimit vendor, rajonal dhe kombëtar.

Nëpërmjet projektaktit synohet arritja e objektivave të mëposhtëm:

a) përshtatja e ndarjes administrativo-territoriale me zhvillimet aktuale demografike, ekonomike, sociale, dhe infrastrukturore;
b) krijimi i njësive të vetëqeverisjes vendore me kapacitete të mjaftueshme administrative, njerëzore dhe financiare me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre;
c) rritja e cilësisë, aksesueshmërisë dhe eficiencës së shërbimeve publike vendore për qytetarët, përfshirë banorët e zonave rurale, periferike dhe të largëta;
ç) zvogëlimi i pabarazive territoriale dhe krijimi i kushteve për një zhvillim më të balancuar ndërmjet zonave urbane dhe rurale;
d) ruajtja dhe respektimi i identitetit historik, kulturor e territorial, i lidhjeve tradicionale dhe i interesave të bashkësive vendore, duke përfshirë pakicat kombëtare;
dh) sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve publike dhe shmangia e pasojave negative për komunitetet gjatë procesit të kalimit në organizimin e ri territorial;
e) forcimi i demokracisë lokale dhe garantimi i përfaqësimit të qytetarëve nëpërmjet forcimit të qyteteve.

Riorganizimi administrativo-territorial nuk përbën vetëm një ndryshim formal të kufijve ose të numrit të njësive të vetëqeverisjes vendore, por krijon **një arkitekturë të re të organizimit territorial** të atillë që u përgjigjet nevojave reale të komuniteteve, duke përmirësuar njëkohësisht ushtrimin e funksioneve vendore, rritur cilësinë e qeverisjes dhe të shërbimeve publike në nivel vendor si dhe duke krijuar premisat e duhura ligjore për përfitimin e fondeve strukturore dhe të kohezionit të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Kjo nismë ligjore është në përputhje me Programin Politik të Këshillit të Ministrave miratuar me vendimin nr. 62/2025 të Kuvendit. Në pjesën "*Pushteti Vendor dhe Zhvillimi Rajonal*", programi qeverisës përcakton si objektiv *krijimin e një qeverisjeje vendore moderne, të fuqizuar financiarisht dhe profesionalisht, të aftë për të garantuar zhvillim të balancuar rajonal dhe shërbime publike cilësore*. Në mënyrë të posaçme, ndër masat prioritare të mandatit është parashikuar realizimi i "*Reformës së re administrativo-territoriale 2.0 dhe përshtatja e saj me standardet e Bashkimit Evropian deri në vitin 2027*". Për rrjedhojë, kjo nismë përbën një instrumentin ligjor të nevojshëm për materializimin e këtij prioriteti politik.

Nisma lidhet edhe me objektivat e tjera të programit qeverisës për fuqizimin financiar dhe institucional të bashkive, zgjerimin e decentralizimit, digjitalizimin e shërbimeve vendore, rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e demokracisë vendore dhe përgatitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për përthithjen e fondeve të kohezionit të Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, riorganizimi territorial nuk vlerësohet si qëllim në vetvete, por si mjet për krijimin e njësive vendore më funksionale, me kapacitete të përshtatshme për ushtrimin e kompetencave dhe për ofrimin e shërbimeve sa më pranë qytetarëve.

Më tej, propozimi për riorganizimin territorial është në përputhje edhe me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030, të miratuar me VKM -në nr. 252, datë 20.4.2023, që synon konsolidimin e mëtejshëm të decentralizimit, zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm, ofrimin e shërbimeve cilësore dhe gjithëpërfshirëse, si dhe rritjen e eficiencës, transparencës dhe llogaridhënies sipas standardeve evropiane. Strategjia mbështet gjithashtu bashkëpunimin ndërbashkiak dhe përdorimin e ekonomive të shkallës, si dhe fuqizimin e rolit të bashkive dhe qarqeve në zhvillimin ekonomik e rajonal.

Gjithashtu, nisma është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 që përbën dokumentin kryesor strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e social të vendit dhe për përmbushjen e standardeve të procesit të integrimit evropian. Në këtë kuadër, riorganizimi territorial kontribuon, në zvogëlimin e pabarazive ndërmjet territoreve, përmirësimin e aksesit në shërbime, forcimin e kapaciteteve administrative vendore dhe përgatitjen e njësive vendore për politikat e kohezionit dhe zhvillimit rajonal të Bashkimit Evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Riorganizimi territorial synon të krijojë ekuilibër të drejtë midis eficiencës së njësive vendore, afërsisë së shërbimit me qytetarin, si dhe nevojës për zhvillim territorial në kuadër të anëtarësimit në BE, duke ruajtur në të njëjtën kohë identitetin e komuniteteve (duke përfshirë pakicat).

Nisma ligjore mbështetet në **veprimtarinë**[1] **dhe gjetjet** e paraqitura në Raportin Përfundimtar të RAT 2.0 të hartuar nga ekspertët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale dhe **gjetjet kryesore nga dëgjesat në 11 qarqe**. Ky komision është krijuar me Vendimin nr. 75 datë 27.10.2025 "*Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë*".

Gjetjet kryesore nga raporti i ekspertëve

Sipas raportit, ndryshimet e thella demografike, ekonomike dhe territoriale kanë krijuar një mospërputhje ndërmjet organizimit ekzistues të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe realitetit të komuniteteve. Censi i vitit 2023 evidenton një popullsi prej 2 402 113 banorësh, rreth 15,2 për qind më të ulët se në vitin 2011, një përqendrim të gati gjysmës së popullsisë në vetëm shtatë bashki dhe rritjen e moshës mesatare në 42,5 vjeç. Këto zhvillime kanë ndikuar drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë demografike, ekonomike, financiare dhe funksionale të një pjese të njësive vendore.

Problematika kryesore e evidentuar në raport është **pabarazia e theksuar territoriale dhe institucionale** ndërmjet bashkive. Një numër i kufizuar njësish kanë autonomi reale fiskale dhe kapacitete të konsoliduara administrative, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbeten strukturalisht të varura nga transfertat e buxhetit qendror. Rreth 40 për qind e bashkive të vogla dhe të mesme nuk arrijnë të mbulojnë me aktivitet buxhetor rreth gjysmën e programeve që u ngarkohen nga legjislacioni. Gjithashtu, më shumë se gjysma e bashkive ndodhen nën nivelin e mesëm të funksionalitetit, ndërsa 47 bashki gjenerojnë individualisht më pak se 1 për qind të të ardhurave të veta vendore në shkallë vendi.

Në lidhje me **ushtrimin e funksioneve**, evidentohen diferenca të konsiderueshme në burimet financiare, kapacitetet profesionale dhe cilësinë e shërbimeve ndërmjet bashkive të mëdha, të mesme dhe të vogla. Nga 41 funksionet vendore të analizuara, vetëm 4 vlerësohen se ushtrohen mirë, ndërsa 21 funksione vlerësohen me nivel të kënaqshëm, 10 funksione me nivel të pamjaftueshëm dhe 6 funksione rezultojnë të paushtruara ose të ushtruara në mënyrë shumë të kufizuar. Krahas kësaj, evidentohen raste të ndërhyrjes së legjislacionit sektorial në kompetencat vendore dhe të transferimit të përgjegjësive pa burimet përkatëse financiare. Për pasojë, aksesi dhe cilësia e shërbimeve publike ndryshojnë në varësi të vendbanimit të qytetarit, duke cenuar objektivin shtetëror të garantimit të një standardi sa më të barabartë shërbimi në të gjithë territorin.

Përparësia kryesore e nismës ligjore qëndron **në përshtatjen e organizimit territorial me të dhënat aktuale demografike, ekonomike, financiare dhe gjeografike**. Riorganizimi nuk mbështetet në një konsolidim mekanik të njësive, por në vlerësimin e tyre kundrejt kritereve të matshme dhe në trajtimin e diferencuar të njësive me veçori identitare, minoritare ose me largësi të konsiderueshme nga qendrat ankoruese. Duke qenë se ekonomitë e shkallës nuk shfaqen në mënyrë të njëjtë për çdo funksion, zgjidhje mund të jetë konsolidimi territorial, organizimi rajonal

[1] Shiko pikën V për procesin konsultativ paraprak.

ose përdorimi i modeleve të shërbimit në distancë. Në të njëjtën kohë, ndryshimet territoriale duhet të shoqërohen me rishikimin e financimit vendor, zbatimin e parimit të "kompetencës së financuar", standardet minimale të shërbimit dhe një plan të posaçëm tranzicioni për asetet, personelin dhe sistemet administrative.

Efektet e pritshme të nismës ligjore shtrihen në planin institucional, financiar, ekonomik dhe social. Në planin institucional, riorganizimi pritet të reduktojë mbivendosjen e kompetencave, të qartësojë përgjegjësitë ndërmjet niveleve të qeverisjes dhe të përmirësojë cilësinë e vendimmarrjes. Në planin financiar, pritet një përdorim më racional i burimeve publike, rritje e autonomisë fiskale, zgjerim i kapacitetit investues dhe ulje e kostove administrative përmes standardizimit të proceseve. Në planin ekonomik, organizimi i ri pritet të përmirësojë klimën e investimeve dhe aftësinë e njësive vendore për të planifikuar zhvillimin dhe për të tërhequr fonde të BE-së. Në planin social, qytetarët pritet të përfitojnë shërbime publike më cilësore, procedura administrative më të thjeshta dhe akses më të mirë në institucionet publike. Në planin e përfaqësimit, qytetarët pritet të kenë më shumë përfaqësim nëpërmjet përfaqësuesve të qytetit të tyre në këshillat bashkiak.

Gjetjet kryesore nga dëgjesat

Procesi i dëgjesave publike i zhvilluar në qarqet Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë ka evidentuar nevojën për konsolidimin e mëtejshëm të organizimit administrativo-territorial. Nga dështmitë e përfaqësuesve vendorë, ish-drejtuesve të komunave dhe bashkive, këshilltarëve, banorëve dhe aktorëve të tjerë vendorë rezulton se ekzistenca e njësive me popullsi, burime financiare dhe kapacitete administrative të kufizuara ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e tyre për të ushtruar funksionet ligjore dhe për të garantuar shërbime të qëndrueshme për qytetarët.

Në dëgjesat publike u evidentua se **njësitë e vogla përballen me vështirësi për të gjeneruar të ardhura të veta, për të mbuluar kostot e administratës dhe për të punësuar personel të specializuar**, si inxhinierë, urbanistë, arkitektë, juristë, ekonomistë dhe ekspertë për hartimin e projekteve. Në këto kushte, kompetencat e njohura formalisht nga legjislacioni nuk shndërrohen gjithmonë në shërbime reale, pasi mungojnë mjetet financiare, teknike dhe njerëzore për ushtrimin e tyre. Kjo problematikë u evidentua veçanërisht në dëgjesat e Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Lezhës dhe Shkodrës (shiko procesverbalet përkatëse të zbardhura)[2].

Një argument tjetër i përsëritur lidhet me **rezultatet e konsolidimit të mëparshëm të njësive të vogla.** Në të gjitha qarqet u paraqitën shembuj të investimeve dhe shërbimeve të realizuara pas konsolidimit, përfshirë rrugë rurale, ujësjellës, kanalizime, pastrim, ndriçim publik, kanale ujitëse e kulluese, shkolla, kopshte, shërbime sociale dhe mbrojtje nga zjarri. Sipas parashtrimeve të qytetarëve/ish funksionarëve të komunave, këto ndërhyrje nuk mund të financoheshin ose të administroheshin nga ish-komunat dhe njësitë e vogla në mënyrë të veçuar. Bashkitë më të mëdha kanë mundësuar përdorimin e përbashkët të mjeteve dhe specialistëve, rritjen e kapacitetit investues dhe rishpërndarjen e të ardhurave drejt zonave rurale e periferike.

Gjatë konsultimeve, qytetarët kanë parashtruar edhe kërkesa konkrete në lidhje me konsolidimin e njësive të qeverisjes vendore, ku ndër të tjera vlen të përmendet që në dëgjesën në Qarkun Dibër

---

[2] https://reformaterritoriale.parlament.al/takimet-ne-qarqe/

u kërkua nga folës që të mos ketë bashki nën 50 000 banorë; në Qarkun Shkodër, folës kërkuan bashki më të pakta dhe më të fuqishme; Qarkun Elbasan u parashtrua kërkesa për zgjerim territorial i bashkisë Cërrik dhe u kundërshtua mbajtja e bashkive me vetëm disa mijë banorë (shiko procesverbalet përkatëse).

Për sa më sipër, edhe nga dëgjesat publike rezulton vetëdija se bashki më të mëdha janë më të afta për të siguruar kapacitet financiar, administrativ dhe profesional të nevojshëm për t'i shërbyer më mirë qytetarëve. Këto propozime/parashtrime që rezultojnë nga procesi konsultativ përkojnë në thelb me gjetjet e evidentuara nga ekspertët në Raport.

Garantimi i demokracisë lokale u ngrit si një prej çështjeve më të rëndësishme gjatë dëgjesave publike. Qytetarët dhe përfaqësuesit vendorë theksuan se çdo ndryshim në organizimin administrativo-territorial duhet të ruajë afërsinë e institucioneve me komunitetin dhe lidhjet tradicionale. Në përgjigje të këtyre kërkesave, projektligji parashikon forcimin e rolit të qyteteve, duke u njohur atyre një status të veçantë ligjor. Në këtë mënyrë, krijohet baza që legjislacioni i mëtejshëm t'i pajisë ato me organe ose struktura përgjegjëse. Propozimi synon të shmangë dobësimin e zërit të komuniteteve brenda njësive vendore më të mëdha. Njëkohësisht, ai krijon kushte që vendimmarrja të jetë më e afërt, më e kuptueshme dhe më e përgjegjshme ndaj realitetit të përditshëm të banorëve. Ruajtja e identitetit historik, kulturor dhe territorial të qyteteve nuk është thjesht çështje simbolike, por një element thelbësor i kohezionit vendor dhe i besimit të qytetarëve te institucionet. Përfaqësimi më i drejtpërdrejtë mundëson që interesat e zonave të ndryshme të përfaqësohen më mirë në politikat dhe prioritetet e bashkive. Kjo qasje forcon demokracinë vendore dhe synon të garantojë që riorganizimi territorial të shoqërohet me mekanizma përfaqësimi funksionalë dhe gjithëpërfshirës në mënyrë që asnjë komunitet të mos mbetet i larguar nga vendimmarrja publike në nivel bashkie.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE-SË

Nisma ligjore është në përputhje me parimet kushtetuese të sanksionuara në nenin 13 të Kushtetutës (decentralizim dhe autonominë vendore), si dhe me normat kushtetuese të posaçme të Pjesës së Gjashtë të saj për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Në përputhje me nenin 108, pika 2, ndarja administrativo-territoriale caktohet me ligj, **mbi bazën e nevojave dhe interesave të përbashkët ekonomikë, si dhe të traditës historike,** ndërsa ndryshimi i kufijve kushtëzohet nga **marrja paraprake e mendimit të popullsisë që banon në njësitë e prekura.**

Në hartimin e nismës është mbajtur parasysh edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr.19/2015). Sipas Gjykatës **zgjedhja e modelit dhe e konfigurimit konkret territorial** i përket, në parim, **hapësirës së vlerësimit të ligjvënësit**, ndërsa **kontrolli kushtetues përqendrohet në respektimin e procedurës së miratimit, të parimeve të decentralizimit dhe autonomisë vendore, të kritereve materiale të nenit 108, pika 2, dhe të detyrimit për konsultimin paraprak të popullsisë.**

Përputhshmëria kushtetuese e nismës, mbështetet në:

(i) **zbatimin e kritereve materiale të nenit 108, pika 2,**
(ii) **konsultimin paraprak të popullsisë;**
(iii) **kryerjen e një analize të bazuar në evidenca për çdo ndryshim të propozuar;**
(iv) **zhvillimin e një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës konsultimi, duke përfshirë mendimet e organeve të vetëqeverisjes vendore (neni 90 i ligjit).**

Nisur nga ky sfond si dhe parashikimet e Kreut XIV të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", sipas të cilit "*riorganizimi me (ose pa) ndryshim të kufijve bëhet kur kjo justifikohet nga interesat ekonomikë dhe socialë, tradita, kultura, lidhjet tradicionale dhe vlerat e tjera vendore, me qëllim realizimin në një nivel më të lartë të funksioneve dhe zbatimin e politikave të zhvillimit vendor e rajonal*", kjo nismë ligjore vjen **në vijim të procesit të nisur nga Komisioni RAT 2.0, gjetjeve kryesore nga dëgjesat dhe Raportit Përfundimtar të RAT 2.0 të hartuar nga ekspertët dhe do të vijojë në përputhje me parashikimet e lartpërmendura, pas depozitimit të saj në Kuvend në përputhje me Rregulloren e Kuvendit**. Procesi që parapriu hartimin/depozitimin e nismës dhe që do të vijoj të zhvillohet më tej pas depozitimit të nismës në Kuvend është i ndërlidhur jo vetëm institucionalisht (sepse është zhvilluar i tëri brenda Kuvendit), por edhe nga pikëpamja llogjike, pasi gjetjet e Raportit shërbejnë si bazë autoritative për hartimin e nismës. Prandaj përputhshmëria me pikat e renditurara më sipër (i) dhe (iii) dhe pjesërisht (iv) reflekton fazën e nismës dhe parashtrohet në këtë relacion. Përmbushja e pikës (ii) dhe pjesërisht pikës (iv) është pjesë e procesit vijues, që do të përfundojë nga Kuvendi në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe ligjore, përpara miratimit të saj përfundimtar.

Në linjë me sa më sipër, relacioni i nismës ligjore, në zbatim të neneve 89–93 të ligjit shoqërohet në këtë fazë me argumentimin ekonomik, social, kulturor, demografik dhe administrativ (shiko Pikën VIII më poshtë) si dhe aneksin përkatës me hartën dhe renditjen e bashkive, qyteteve dhe njësive përbërëse të tyre që propozohet të riorganizohet. Nisma ligjore, pas regjistrimit si e tillë ne Kuvend:

- do të dërgohet për mendim zyrtar në organet vendore (këshillat bashkiakë dhe të qarqeve, që janë të përfshirë drejtpërdrejt në riorganizim, si dhe kryetarët) sipas nenit 90 të ligjit nr. 139/2015;
- do t'i nënshtrohet për mendimit të popullsisë së prekur nga organet vendore në bashkitë që preken nga riorganizimi dhe mendimi i popullsisë do t'i përcillet Kuvendit; në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19/2015; Gjykata ka vlerësuar se marrja e mendimit të popullsisë është detyrim kushtetues, por nuk barazohet domosdoshmërisht me marrjen e pëlqimit dhe nuk kërkon në çdo rast zhvillimin e një referendumi; ajo mund të realizohet edhe nëpërmjet *takimeve të hapura, seancave të këshillimit, dëgjesave publike, sondazheve të besueshme dhe formave të tjera të përshtatshme, me kusht që konsultimi të jetë paraprak, real dhe i dokumentuar.*
- do t'i dërgohet për mendim zyrtar edhe (i) Këshillit të Ministrave duke përfshirë Ministrisë së Financave për rregullimin e çështjeve financiare, pasurore dhe të detyrimeve ndaj të tretëve, në përputhje me parashikimet ligjore; (ii) institucioneve të pavarura kushtetues si Avokati i Popullit, KLSH-së si dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi; dhe Komitetit për Pakicat Kombëtare.

Në vijim të marrjes së mendimit nga institucionet e lartpërmendura, në kuadër të diskutimit të tyre do të adresohen/parashikohen edhe masat për garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve gjatë periudhës kalimtare.

Nisma ligjore është hartuar **bazuar në parashikimet e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore**, të ratifikuar me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999, dhe pjesë të rendit juridik të brendshëm. Karta nuk imponon një numër të caktuar njësish ose një model unik të organizimit territorial, por kërkon që **modeli i zgjedhur të garantojë aftësinë efektive të autoriteteve vendore për ushtrimin e përgjegjësive të tyre, respektimin e subsidiaritetit, konsultimin paraprak për ndryshimet e kufijve dhe burime financiare të përshtatshme me kompetencat e ushtruara.** Për rrjedhojë, ligjshmëria e riorganizimit duhet të vlerësohet jo vetëm mbi bazën e kufijve të rinj, por edhe mbi aftësinë e njësive që rezultojnë prej tij për të ushtruar funksionet vendore në mënyrë efektive, të pavarur dhe në interes të popullsisë.

Gjithashtu, nisma është hartuar duke patur parasysh detyrimet kushtetuese dhe konventore të Republikës së Shqipërisë në lidhje me **mbrojtjen e pakicave kombëtare si dhe parashikimet e Ligjit nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë".** Riorganizimi i propozuar nuk sjell asnjë kufizim/cenim të të drejtave të këtyre komuniteteve, dobësim të përfaqësimit të tyre ose cenim të mundësisë për ruajtjen dhe shprehjen e identitetit vendor.

Së fundmi, në funksion të garantimit të **sigurisë juridike**, nisma përfshin dispozita të qarta kalimtare për transferimin e kompetencave, pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiveve, arkivave, kontratave, detyrimeve financiare dhe personelit. Transferimi bazohet në **parimin e vazhdimësisë funksionale, në mënyrë që çdo pasuri dhe burim t'i kalojë institucionit që merr përgjegjësinë për shërbimin përkatës dhe që gjatë tranzicionit të mos krijohen ndërprerje në shërbimet publike ose pasiguri në marrëdhëniet juridike ekzistuese.**

Nisma nuk ka për objekt transpozimin e drejtpërdrejtë të një direktive ose rregulloreje të posaçme të Bashkimit Evropian. Organizimi administrativo-territorial dhe përcaktimi i numrit, kufijve dhe modelit institucional të njësive vendore janë kompetencë ekskluzive e vetë shtetit dhe përcaktohet në përputhje me rendin e tyre kushtetues. Megjithatë, nisma ka lidhje të drejtpërdrejtë funksionale me kërkesat e **Kapitullit 22 të *acquis***, "Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore". *Acquis* në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulla kuadër dhe zbatuese për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të fondeve strukturore dhe të kohezionit, duke reflektuar organizimin territorial të çdo shteti. Ai kërkon ekzistencën e një kuadri institucional të përshtatshëm dhe kapaciteteve administrative për programimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e fondeve. Në këtë këndvështrim, nisma kontribuon tërthorazi në përafrimin funksional me *acquis* nëpërmjet krijimit të njësive vendore dhe, sipas modelit të zgjedhur, strukturave rajonale me kapacitete të mjaftueshme për planifikim territorial, bashkërendim ndërinstitucional, përgatitje dhe menaxhim projektesh, monitorim dhe administrim financiar. Ky organizim duhet të mundësojë pjesëmarrjen efektive të nivelit vendor dhe rajonal në programimin e politikës së kohezionit dhe në zbatimin e parimit të partneritetit. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025[3] e vlerëson vendin si mesatarisht të përgatitur në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore dhe kërkon forcimin e përgatitjeve e të kapaciteteve për programimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin, komunikimin, menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin, përfshirë ngritjen e kapaciteteve

[3] Fq.18. Albania Report 2025, https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2025_en

në nivel qendror, rajonal dhe vendor. Për rrjedhojë, riorganizimi territorial duhet të shoqërohet me përcaktimin e qartë të përgjegjësive, burimeve njerëzore dhe financiare dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet niveleve të qeverisjes.

V. PROCESI KONSULTATIV PËR HARTIMIN E KËTIJ PROJEKTLIGJI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrative-Territoriale u krijua me Vendimin e Kuvendit Nr.75 datë 27.10.2025 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrative-Territoriale në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij vendimi, Komisioni

- shqyrton kuadrin ligjor dhe institucional të qeverisjes vendore;
- analizon dhe propozon opsione për ridizajnimin territorial dhe forcimin e kapaciteteve administrative të njësive të qeverisjes vendore;
- analizon sistemin aktual të financave vendore dhe rekomandon masa për qëndrueshmërinë financiare dhe rritjen e qëndrueshmërisë së njësive të vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë forcimin e decentralizimit fiskal, rritjen e të ardhurave vendore, optimizimin e shpenzimeve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar;
- shqyrton cilësisë dhe aksesueshmërisë së shërbimeve publike vendore;
- siguron përputhshmërinë e propozimeve me acquis të Bashkimit Evropian dhe politikat rajonale të kohezionit;
- zhvillon një proces konsultimi gjithëpërfshirës dhe transparent me njësitë e qeverisjes vendore, shoqatat e tyre, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- paraqet në Kuvend një dokument analitik me rekomandime për hapa të mëtejshëm dhe propozime ligjore të hartuara.

Komisioni përbëhej nga 16 anëtarë me barazi anëtarësie midis shumicës parlamentare dhe pakinës parlamentare. Afati i veprimtarisë së Komisionit ishte deri në datën 15.07.2026. Komisioni ka zbatuar një qasje transparente dhe inovative komunikimi me publikun; është hapur edhe një faqe e dedikuar për këtë komision (https://reformaterritoriale.parlament.al/) mundësuar nga Projekti Bashki të Forta, Financuar nga Qeveria Zvicerane dhe ajo Suedeze dhe menaxhuar nga Helvetas. Projekti asiston Komisionin e posacëm për RAT dhe konsiston në ndërtimin e ndërfaqes Ëeb për Reformën, organiznimin e takimeve konsultuese si dhe mbështetje me 12 ekspertë të Komisionit parlamentar për RAT.

Komisioni ndoqi një **qasje shumëdimensionale** në mënyrë që të mundësohej aksesi i qytetarëve, komuniteteve, OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit në këtë proces. Krahas dëgjesave/seancave të zhvilluara nga Komisioni sipas kalendarit të dakordësuar midis dy palëve politike, komunikimeve shkresore zyrtare, u përdorën edhe mjetet e komunikimit elektronik si mënyrë për të rritur përfshirjen dhe transparencën. **Procesi konsultativ, së bashku me të dhënat e paraqitura zyrtarisht nga Institucionet, OJF-të, komunitet dhe aktorë të ndryshëm[4] si dhe ato nga burimet e hapura, krijoi bazën për evidentimin nga ana e ekspertëve të RAT të problematikave, sfidave dhe nevojave që lidhen me funksionimin e pushtetit vendor dhe me reformën administrativo-territoriale.**

Seancat e Komisionit

[4] Këto korrespondenca janë administruar nga Komisioni.

Komisioni RAT 2.0 u konstituua më 11 nëntor 2025, duke shënuar fillimin formal të veprimtarisë së tij. Veprimtaria e tij u nda në dy faza kryesore: faza e organizimit të brendshëm, që përfshiu miratimin e strukturave, ekspertëve, procesverbaleve, planit të punës dhe kalendarit, dhe faza e konsultimeve me popullin/komunitetet (qytetarë, OJF, figura të spikatura në komunitet, biznese etj.) si dhe me përfaqësues të ekzekutivit, kryetarë bashkish etj.

Në mbledhjen e datës 27 nëntor 2025, Komisioni shqyrtoi çështjet kryesore të organizimit të brendshëm, përfshirë projektvendimin për caktimin e sekretarit, projektkalendarin e punës, si dhe projektvendimin për përcaktimin e numrit të ekspertëve që do të angazhoheshin pranë tij. Këto çështje u trajtuan përsëri në mbledhjet e datave 22 janar, 2 shkurt dhe 11 shkurt 2026, krahas miratimit të procesverbalit të mbledhjes së datës 11 nëntor 2025 dhe shqyrtimit të projektvendimit për miratimin e emrave të ekspertëve.

Në mbledhjen e datës 11 shkurt 2026, Komisioni trajtoi gjithashtu miratimin e planit të punës dhe të kalendarit të veprimtarisë, të përshtatur me afatet e reja. Më 16 shkurt 2026, miratimi i planit të punës dhe i kalendarit përbëri çështjen kryesore të mbledhjes. Më 25 mars 2026, Komisioni miratoi kalendarin e detajuar të takimeve për fazën e parë të konsultimeve në territor, duke kaluar nga faza organizative në fazën e konsultimit institucional dhe vendor.

Më 7 prill 2026, Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datave 11 dhe 25 mars 2026 dhe zhvilloi një seancë dëgjimore me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo. Kjo seancë kishte si objekt njohjen e Komisionit me gjendjen e pushtetit vendor dhe me sfidat që paraqiteshin në funksionimin e tij.

Më poshtë është tabela që pasqyron veprimtarinë:

Nr.	Data	Ora	Vendi/Qarku	Rendi i ditës / Veprimtaria
1	11 nëntor 2025	12:00	Kuvendi	Konstituimi i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale.
2	27 nëntor 2025	12:00	Kuvendi	Shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e sekretarit të Komisionit; shqyrtimi i projektkalendarit të punës së Komisionit; shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e numrit të ekspertëve pranë Komisionit; çështje të tjera.
3	22 janar 2026	11:00	Kuvendi	Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.11.2025; shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e sekretarit të Komisionit; shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e emrave të ekspertëve pranë Komisionit; çështje të tjera.
4	2 shkurt 2026	13:00	Kuvendi	Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.11.2025; shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e sekretarit të Komisionit; shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e emrave të ekspertëve pranë Komisionit; çështje të tjera.
5	11 shkurt 2026	14:30	Kuvendi	Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 11.11.2025; shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e sekretarit të Komisionit; miratimi i planit të punës dhe i kalendarit të Komisionit, në përputhje me afatet e reja; shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e emrave të ekspertëve pranë Komisionit; çështje të tjera.
6	16 shkurt 2026	13:00	Kuvendi	Miratimi i planit të punës dhe i kalendarit të Komisionit, në përputhje me afatet e reja.
7	25 mars 2026	13:00	Kuvendi	Miratimi i kalendarit të detajuar të takimeve për fazën e parë të konsultimeve në territor.

8	7 prill 2026	14:00	Kuvendi	Miratimi i procesverbaleve të datave 11 dhe 25 mars 2026; seancë dëgjimore me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo, për njohjen me gjendjen e pushtetit vendor dhe sfidat e tij; çështje të tjera.

Pas kësaj seance, Komisioni ka vijuar me **zhvillimin e takimeve në qarqe të ndryshme të vendit**.

Këto takime përfaqësonin një pjesë (fazë) të procesit të konsultimit në territor dhe synonin mbledhjen e qëndrimeve, problematikave dhe vlerësimeve që lidheshin me organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Krahas dëgjesave në qarqe, Komisioni organizoi edhe seanca të posaçme me kryetarët e bashkive.

Kalendari të gjitha seancave/dëgjesave të zhvilluara nga Komisioni është si më poshtë:

Nr.	Data	Ora	Vendi/Qarku	Rendi i ditës / Veprimtaria
1	22 prill 2026	17:00	Qarku Lezhë	Seancë dëgjimore.
2	24 prill 2026	15:00	Qarku Gjirokastër	Seancë dëgjimore.
3	28 prill 2026	17:00	Qarku Elbasan	Seancë dëgjimore.
4	5 maj 2026	17:00	Qarku Vlorë	Seancë dëgjimore.
5	12 maj 2026	17:00	Qarku Fier	Seancë dëgjimore.
6	13 maj 2026	10:00–16:30	Kuvendi	Seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive: **Elbasan**, 10:00–12:30; **Kukës**, 13:00–14:30; **Durrës**, 15:00–16:30.
7	15 maj 2026	17:00	Qarku Shkodër	Seancë dëgjimore.
8	19 maj 2026	17:00	Qarku Durrës	Seancë dëgjimore.
9	20 maj 2026	10:00–17:00	Kuvendi	Seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive: **Gjirokastër**, 10:00–12:00; **Lezhë**, 13:30–15:00; **Korçë**, 15:30–17:00; çështje të tjera.
10	22 maj 2026	17:00	Qendra Rinore Peshkopi, Dibër	Seancë dëgjimore për qarkun Dibër.
11	28 maj 2026	10:00–17:00	Kuvendi	Seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive: **Berat**, 10:00–12:00; **Fier**, 12:00–14:00; **Shkodër**, 15:30–17:00.
12	26 maj 2026	17:00	Qarku Kukës	Seancë dëgjimore.
13	3 qershor 2026	10:00–17:00	Kuvendi	Seancë dëgjimore me kryetarët e bashkive: **Dibër**, 10:00–12:00; **Vlorë**, 12:00–14:00; **Tiranë**, 15:30–17:00.
14	5 qershor 2026	17:00	Qarku Berat	Seancë dëgjimore.
15	15 Korrik 2026	14:00	Kuvendi	Prezantimi i raportit të ekspertëve dhe progresit të punës së Komisionit

Gjatë periudhës nëntor 2025–qershor 2026, Komisioni zhvilloi në tërësi 23 mbledhje dhe seanca të planifikuara. Të gjitha takimet dhe seancat janë transmetuar *live* në kanalin e Kuvendit në youtube. Në faqen e internetit https://reformaterritoriale.parlament.al/ janë vendosur përveç procesverbaleve të zbardhura (të plota) të diskutimeve edhe një përmbledhje e hartuar dhe dakordësuar nga ekspertët e projektit Bashki të Forta [5]. Në total në faqe janë ngarkuar 2,747

[5] https://reformaterritoriale.parlament.al/takimet-ne-qarqe/.

materiale (dokumente, video etj.) me numër shikimesh në total **1,188 dhe 587 përdorues aktive.** Qytetarët gjatë kësaj kohe kanë parashtruar 43 komente.

Korrespondenca institucionale

Gjatë periudhës 4 mars–10 korrik 2026, Komisioni i Posaçëm ka administruar **88 regjistrime hyrëse në protokoll**, të lidhura drejtpërdrejt me procesin e shqyrtimit dhe rishikimit të organizimit administrativo-territorial. Korrespondenca e administruar përfshin kërkesa, peticione, propozime, përgjigje institucionale, raporte, informacione teknike dhe shkresa mbështetëse të paraqitura nga institucione publike, bashki, organizata të shoqërisë civile, komunitete vendore, grupe interesi, përfaqësues të pakicave kombëtare, diaspora dhe partnerë ndërkombëtarë.

Korrespondenca me njësitë e vetëqeverisjes vendore

Në kuadër të sigurimit të të dhënave dhe të informacionit të nevojshëm për analizën e ndarjes aktuale administrativo-territoriale, Komisioni ka zhvilluar një korrespondencë të gjerë me bashkitë e vendit. Komisioni ka administruar kthim-përgjigje, të dhëna dhe informacione nga bashkitë Dibër, Bulqizë, Vlorë, Mat, Selenicë, Peqin, Lushnjë, Klos, Dropull, Maliq, Librazhd, Patos, Prrenjas, Has, Libohovë, Memaliaj, Divjakë, Vau i Dejës, Belsh, Berat, Kurbin, Pogradec, Tepelenë, Malësi e Madhe, Sarandë, Fier, Përmet, Vorë, Lezhë, Mallakastër, Rrogozhinë, Elbasan, Kolonjë, Këlcyrë dhe Poliçan. **Informacioni i përcjellë nga bashkitë ka shërbyer për evidentimin e të dhënave territoriale, demografike, administrative, funksionale dhe financiare, si dhe për identifikimin e problematikave të hasura në ofrimin e shërbimeve publike dhe në administrimin e territorit.** Komisioni ka administruar gjithashtu qëndrime dhe propozime të drejtpërdrejta nga disa bashki lidhur me organizimin e dëgjesave publike dhe me çështje konkrete të reformës. Në këtë kuadër përfshihen kërkesat e Bashkisë Poliçan, Bashkisë Konispol, Bashkisë Devoll, Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Bashkisë Mirditë.

Korrespondenca me institucionet qendrore

Komisioni ka kërkuar dhe administruar informacion nga ministritë dhe institucionet qendrore, me qëllim sigurimin e një baze të plotë dhe të verifikueshme të të dhënave për vlerësimin e reformës administrativo-territoriale.

Në këtë kuadër, Komisioni ka marrë përgjigje ose informacione nga:

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;
- Ministria e Financave;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Bujqësisë;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Instituti i Statistikave.

Korrespondenca me këto institucione ka pasur si objekt mbledhjen e informacionit mbi funksionet dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore, financimin vendor, investimet publike, strehimin, të dhënat statistikore, projektet e realizuara ndër vite dhe problematikat e transferimit të funksioneve nga qeverisja qendrore në nivel vendor.

Një pjesë e rëndësishme e dokumentacionit lidhet me transferimin e funksioneve nga pushteti qendror te njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me vështirësitë financiare që shoqërojnë ushtrimin e këtyre funksioneve. **Këto të dhëna përbëjnë një element me rëndësi për vlerësimin e kapaciteteve administrative dhe financiare të bashkive dhe për përcaktimin e qëndrueshmërisë së njësive ekzistuese.**

Peticionet

Komisioni ka marrë dhe administruar disa peticione që lidhen me ruajtjen ose ndryshimin e statusit të njësive të vetëqeverisjes vendore.
Një nga çështjet më të përfaqësuara në korrespondencë është ruajtja e Bashkisë Devoll si njësi më vete administrativo-territoriale. Banorët e Bashkisë Devoll kanë paraqitur një peticion me objekt që Bashkia Devoll të vijojë të funksionojë si bashki më vete. Kjo nismë është mbështetur edhe nga Shoqata Atdhetare Kulturore "Devolli" dhe nga vetë Bashkia Devoll.
Për Bashkinë Klos janë administruar kërkesa dhe peticione nga banorët, subjektet e biznesit dhe të rinjtë e forumit rinor vendor. Këto shkresa kundërshtojnë çdo iniciativë për shkrirjen e Bashkisë Klos dhe kthimin e saj në njësi administrative në varësi të Bashkisë Mat. Peticionet argumentojnë nevojën për ruajtjen e statusit aktual të bashkisë dhe përfaqësimin e drejtpërdrejtë të komunitetit në nivel vendor.
Komisioni ka administruar gjithashtu kërkesën për ruajtjen e Bashkisë Pustec dhe mosprekjen e statusit të saj në kuadër të reformës së re administrativo-territoriale. Kjo kërkesë lidhet edhe me mbrojtjen e interesave të komunitetit dhe të pakicave kombëtare që jetojnë në territorin e kësaj bashkie.
Në dokumentacion përfshihet edhe një kërkesë nga përfaqësues të pakicës kombëtare bullgare në Shqipëri, e cila duhet të vlerësohet në kuadër të standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e pakicave, përfaqësimin dhe aksesin në shërbimet publike vendore.

Propozimet për krijimin ose riorganizimin e njësive vendore

Komisioni ka administruar propozime konkrete për krijimin e bashkive të reja, rikthimin e njësive të mëparshme dhe ndryshimin e përkatësisë administrative të njësive ekzistuese.
Banorët e Velipojës kanë kërkuar rishikimin e ndarjes nga Bashkia Shkodër dhe krijimin e Bashkisë Velipojë. Kërkesa lidhet me karakteristikat territoriale, ekonomike dhe turistike të zonës, si dhe me pretendimin për nevojën e një administrimi më të drejtpërdrejtë të territorit.
Është administruar gjithashtu një propozim për krijimin e bashkive Gollobordë dhe Gorë si njësi të reja të vetëqeverisjes vendore. Ky propozim paraqet një çështje që kërkon analizë të posaçme në lidhje me kriteret demografike, territoriale, historike, kulturore dhe funksionale, si dhe me përfaqësimin e komuniteteve përkatëse.
Një çështje tjetër konkrete është kërkesa për kalimin e Njësisë Administrative Martanesh nga Bashkia Bulqizë në Bashkinë Tiranë. Kërkesa është paraqitur nga përfaqësues të komunitetit dhe nga Shoqata Atdhetare Kulturore "Martanesh". Për shqyrtimin e saj kërkohet vlerësim i lidhjeve funksionale, infrastrukturës, distancës nga qendra administrative, aksesit në shërbime dhe interesit të banorëve.
Komisioni ka administruar edhe shkresa që lidhen me Njësinë Administrative Steblevë, Njësinë Administrative Cukalat dhe fshatin Kasallë në Njësinë Administrative Zall-Herr. Këto kërkesa pasqyrojnë problematika të lidhura me përfaqësimin, aksesin në shërbime, largësinë nga qendrat administrative dhe nevojën për konsultim të drejtpërdrejtë me banorët.

Përfshirja e diasporës

Komisioni ka administruar kërkesa nga përfaqësues të diasporës së Hasit në Mbretërinë e Bashkuar, të përcjella edhe nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
Përfshirja e diasporës në proces lidhet me interesin e saj për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës së origjinës, ruajtjen e lidhjeve komunitare dhe ndikimin që organizimi territorial mund të ketë mbi investimet, pronën, shërbimet dhe përfaqësimin vendor. Korrespondenca e administruar tregon se reforma administrativo-territoriale nuk perceptohet vetëm si çështje e administrimit të territorit, por edhe si proces me ndikim të drejtpërdrejtë mbi identitetin lokal, lidhjet historike dhe marrëdhëniet e komuniteteve me diasporën.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile

Komisioni ka administruar kërkesa, propozime dhe materiale nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, përfshirë:

- Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri;
- Qendrën Aleanca Gjinore për Zhvillim;
- Shoqatën Eko-Turizimi Pukë dhe Fushë-Arrëz;
- Shoqatën Kulturore Atdhetare "Hasi";
- Shoqatën Atdhetare Kulturore "Devolli";
- Shoqatën "Zambak – Boshnjakët e Shqipërisë";
- Shoqatën "Tomorri";
- Shoqatën Atdhetare Kulturore "Martanesh".

Pjesëmarrja e këtyre organizatave ka mundësuar që Komisioni të marrë në konsideratë perspektiva të ndryshme lidhur me të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore, zhvillimin e qëndrueshëm, turizmin, mbrojtjen e identitetit kulturor, përfaqësimin e pakicave dhe nevojat specifike të komuniteteve *lokale.*

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

Komisioni ka zhvilluar komunikim me partnerë ndërkombëtarë dhe organizata zhvillimore, me qëllim sigurimin e ekspertizës dhe mbështetjes teknike për procesin e reformës. Ambasada e Zvicrës në Shqipëri ka mbështetur punë e Komisionit si dhe në protokoll është administruar edhe një raport i HELVETAS-it për Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale. Materialet e partnerëve ndërkombëtarë kontribuan në analizën krahasuese të modeleve të qeverisjes vendore, përcaktimin e kritereve objektive për organizimin territorial dhe identifikimin e praktikave të mira ndërkombëtare.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

Neni 1 përcakton se njësitë e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë janë bashkitë (...) dhe qarqet (12). Pika 2 e këtij neni parashikon se bashkia si njësia bazë e qeverisjes vendore përbëhet nga qytetet. Projektligji përcakton se qytetet përbëhen nga njësitë administrative dhe/ose fshatrat dhe i njeh qyteteve status të veçantë ligjor, i cili do të rregullohet me ligjin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Për rrjedhojë, një bashki mund të ketë më shumë se 1 qytet në përbërjen e saj. Qytetet janë zonat funksionale në të cilën gravitojnë njësitë përbërëse dhe

fshtrat. Organizimi dhe përfaqësimi i bashkisë mbështeten në parimin e përfaqësimit proporcional të qyteteve përbërëse, në përpjesëtim me popullsinë e tyre.

Neni 2 parashikon se emërtimi, shtrirja territoriale, kufijtë, qendra, njësitë administrative përbërëse të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe nënndarjet e tyre janë të përcaktuara në hartat dhe në tabelat bashkëlidhur projektligjit dhe mund të ndryshojnë në përputhje me parashikimet e tij. Në këtë nen, i njihet e drejta këshillave bashkiake që të mund të vendosin ndryshimin e emërtimit, shtrirjes territoriale dhe kufijve të njësive administrative përbërëse dhe nënndarjeve të tyre, sipas nevojave të komuniteteve vendore dhe efektshmërisë administrative dhe jo më shpesh se një herë në 10 vjet. Gjithashtu, këshilli bashkiak përpara shqyrtimit dhe miratimit të vendimit, informon publikun dhe zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë që banon në ato. Këshilli i Ministrave miraton përfundimisht ndryshimin e emërtimit, shtrirjes territoriale dhe kufijve e njësive administrative përbërëse dhe nënndarjeve të tyre. Nga ana tjetër, parashikohet se një vit para datës së zgjedhjeve qendrore dhe vendore ndalohet propozimi dhe miratimi i projektaktit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 3 përcakton se organet e njësive të qeverisjes vendore, të konstituuara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2023 dhe me juridiksion territorial sipas ndarjes administrativo-territoriale, të përcaktuar me ligjin nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", do të vazhdojnë funksionimin e tyre deri në konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore në zgjedhjet e vitit 2027. Sipas pikës 2 të nenit 3, parashikohet se zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2027 do të organizohen dhe zhvillohen mbi bazën e ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj. Gjithashtu parashikohet se organet e qeverisjes vendore, të konstituuara pas zgjedhjeve vendore të vitit 2027, do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në këtë ligj.

Neni 4 përcakton detyrimin për Këshillin e Ministrave, që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë me vendim detajimin teknik të vijës ndarëse të hartës së kufijve administrativo-territorialë të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në tabelat e këtij ligji, në përputhje me standardet gjeohapësinore në fuqi.

Neni 5 parashikon se ligji nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" shfuqizohet.

Neni 6 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. ANALIZA E FUNKSIONEVE TË NJQV-VE

1. Ndryshimet demografike

Raporti Përfundimtar i Reformës Administrativo-Territoriale 2.0 evidenton se **ndryshimet demografike përbëjnë një faktor strukturor** që duhet të merret në konsideratë gjatë vlerësimit të organizimit aktual territorial. Sipas të dhënave të detajuara të Censit 2023, popullsia banuese e

Shqipërisë rezulton 2 402 113 banorë, rreth 398 mijë banorë më pak se në vitin 2011, ose një rënie prej 14,2 për qind. Krahasuar me vitin 1989, vendi ka humbur rreth 24,5 për qind të popullsisë.

Ritmi i rënies është përshpejtuar nga njëri cens në tjetrin, duke e shndërruar tkurrjen demografike nga një prirje graduale në një dukuri që ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e njësive vendore, bazën e tyre fiskale dhe planifikimin e shërbimeve publike. Ndryshimi demografik nuk është shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme në territor. Lëvizjet e brendshme të popullsisë kanë vijuar drejt Tiranës, zonave bregdetare dhe qendrave kryesore urbane, ndërsa zona të tjera, veçanërisht ato rurale dhe të brendshme, kanë humbur një pjesë të konsiderueshme të banorëve. Boshti Tiranë–Durrës përqendron rreth 41 për qind të popullsisë së vendit, kundrejt 21 për qind në vitin 1989, ndërsa Tirana përfaqëson e vetme rreth 31,6 për qind të popullsisë kombëtare. Ky përqendrim krijon presion të shtuar mbi infrastrukturën, transportin, strehimin dhe shërbimet publike në qendrat pritëse, ndërkohë që njësitë që humbasin popullsi përballen me nënshfrytëzim të kapaciteteve dhe rritje të kostos së shërbimeve për banor.

Diferencat territoriale vërehen edhe në nivel qarku. Gjatë periudhës 2011–2023, Tirana ka regjistruar një rritje të lehtë prej 1,2 për qind dhe Berati ka mbetur pothuajse i qëndrueshëm, me një rënie prej 0,7 për qind. Në të kundërt, rëniet më të larta janë regjistruar në qarqet Shkodër, me 28,3 për qind, Kukës, me 27,3 për qind, dhe Lezhë, me 25,8 për qind. Edhe Qarku i Durrësit ka shënuar një rënie prej 13,7 për qind, pavarësisht rolit të tij si një nga polet kryesore urbane dhe ekonomike të vendit. Këto të dhëna tregojnë se organizimi territorial duhet të vlerësohet jo vetëm mbi numrin e përgjithshëm të banorëve, por edhe mbi drejtimin e lëvizjeve, dendësinë, shpërndarjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të popullsisë.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është **plakja e popullsisë.** Mosha mesatare është rritur nga 35,3 vjeç në vitin 2011 në 42,5 vjeç në vitin 2023. Pesha e personave 65 vjeç e lart është rritur nga 11,3 për qind në 19,7 për qind, çka do të thotë se afërsisht një në pesë banorë i përket kësaj grupmoshe. Njëkohësisht, raporti i varësisë së të rinjve është ulur nga 30,4 në 24 për qind, ndërsa raporti i varësisë së të moshuarve është rritur nga 16,7 në 30,4 për qind. Kjo dinamikë ndryshon përmbajtjen e nevojave vendore, duke rritur kërkesën për shërbime sociale, kujdes shëndetësor, asistencë në komunitet dhe shërbime të aksesueshme për të moshuarit.

Në njësitë me tkurrje të fortë dhe plakje të popullsisë, reduktohen baza e taksapaguesve, fuqia punëtore dhe potenciali ekonomik, ndërsa kostot fikse të administratës dhe të ofrimit të shërbimeve vazhdojnë të mbeten të larta. Në njësitë me popullsi të shpërndarë, terren të vështirë ose largësi të mëdha ndërmjet vendbanimeve, rënia demografike mund të rrisë më tej koston për frymë të transportit, administrimit dhe ofrimit të shërbimeve. Në anën tjetër, njësitë urbane që tërheqin popullsi përballen me kërkesë në rritje për investime dhe zgjerim të kapaciteteve publike.

Nisur nga ky sfond, nisma ligjore synon që organizimi territorial dhe shpërndarja e burimeve financiare të përshtaten me realitetin demografik të evidentuar nga Censi 2023. **Riorganizimi duhet të marrë në konsideratë jo vetëm popullsinë aktuale, por edhe tendencën e saj, strukturën sipas moshës, dendësinë, shkallën e urbanizimit, kompaktësinë territoriale dhe aftësinë e njësisë për të ruajtur një bazë të qëndrueshme demografike dhe funksionale.**
Për sa më sipër, ndryshimet demografike mbështesin nevojën për rivlerësimin e organizimit territorial, por nuk mund të përdoren si kriter i vetëm dhe duhet të analizohen së bashku me

funksionalitetin e njësive, kapacitetet financiare dhe administrative, distancën dhe aksesin në shërbime, si dhe karakteristikat sociale, kulturore dhe identitare të komuniteteve.

2. Mungesa e efiçencës në ofrimin e shërbimeve

Raporti i ekspertëve dhe parashtrimet nga dëgjesat në Qarqe konvergojnë në pikën **që eficienca në ofrimin e shërbimeve duhet të vlerësohet vetëm nga aftësia reale e bashkive për t'i ushtruar funksionet në mënyrë të vazhdueshme, me burime të mjaftueshme dhe me cilësinë e kërkuar për qytetarët.** Në këtë drejtim, Raporti konstaton **diferenca të konsiderueshme ndërmjet bashkive për sa u përket kapaciteteve financiare, administrative dhe njerëzore, të cilat reflektohen drejtpërdrejt në nivelin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.** Për pasojë, aksesi në shërbime të tilla si furnizimi me ujë, pastrimi, transporti, kujdesi social dhe shërbimet administrative vazhdon të ndryshojë në varësi të territorit ku banon qytetari.
Të dhënat financiare dhe funksionale të raportit tregojnë se bashkitë financojnë dhe ushtrojnë mesatarisht vetëm 15,8 nga 34 funksione të matshme, ose rreth 46,3 për qind të tyre. Në 42 bashki mbulohen më pak se gjysma e funksioneve të matshme, ndërsa vetëm 5 bashki arrijnë të mbulojnë 24 ose më shumë funksione. Kjo tregon se përgjegjësitë e parashikuara nga legjislacioni nuk shoqërohen në të gjitha rastet me kapacitetin real financiar dhe institucional për t'i kthyer ato në shërbime efektive për qytetarët. Problematika paraqitet më e theksuar në bashkitë e vogla dhe të mesme. Rreth 40 për qind e këtyre bashkive nuk arrijnë të financojnë plotësisht rreth gjysmën e programeve buxhetore që lidhen me funksionet e tyre ligjore. Në disa njësi vendore nuk ushtrohen plotësisht funksione të tilla si administrimi i pyjeve, ujitja dhe kullimi, arsimi parashkollor dhe mbrojtja nga zjarri. Bashkitë me më pak se 10 mijë banorë mbulojnë mesatarisht 12,8 funksione, ndërsa bashkitë me 50–150 mijë banorë mbulojnë mesatarisht 21,3 funksione. Mungesa e eficiencës lidhet gjithashtu me peshën e kostove administrative dhe me shpërndarjen jo optimale të burimeve njerëzore. Bashkitë e vogla kanë mesatarisht rreth 26 punonjës bashkiakë për 1 000 banorë, kundrejt 16 punonjësve në bashkitë e mesme dhe 13 punonjësve në bashkitë e mëdha. Kjo tregon se njësitë me popullsi të vogël mbajnë një ngarkesë më të lartë administrative për banor, ndërsa kanë më pak mundësi për të siguruar staf të specializuar për funksionet teknike dhe shërbimet komplekse. Më tej evidentohet se bashkitë e mëdha regjistrojnë një nivel mesatar më të lartë të ushtrimit të funksioneve, me vlerësim 2,36 në shkallën 0–3, kundrejt 1,87 për bashkitë e mesme dhe 1,88 për bashkitë e vogla. Raporti sqaron se madhësia territoriale nuk është faktori i vetëm që përcakton eficiencën. Autonomia fiskale, pozicioni gjeografik, kapacitetet institucionale, burimet njerëzore dhe qartësia e kompetencave ndikojnë po aq në aftësinë e bashkive për të ofruar shërbime. Për rrjedhojë, bashki me numër të përafërt banorësh mund të paraqesin nivele shumë të ndryshme performance. Eficienca ndryshon edhe sipas natyrës së funksionit, kështu shërbime të tilla si ndriçimi publik, menaxhimi i mbetjeve, administrimi i pyjeve dhe kullotave, arsimi parashkollor dhe shërbimet sociale përfitojnë më shumë nga kapacitetet e zgjeruara dhe ekonomitë e shkallës. Për funksione të tjera, si infrastruktura rrugore, planifikimi territorial, mbrojtja civile, policia bashkiake dhe aktivitetet kulturore, madhësia e bashkisë nuk paraqitet si përcaktuesi i vetëm. Performanca e ulët në zhvillimin ekonomik vendor dhe mbrojtjen e mjedisit lidhet kryesisht me kufizime institucionale, organizative, financiare dhe ligjore.

Një tjetër faktor që kufizon eficiencën është **fragmentimi i investimeve vendore** në projekte të vogla, të cilat nuk lidhen gjithmonë me standardet e shërbimit dhe nuk prodhojnë ndikim të qëndrueshëm. Në vitin 2025, rreth 22 për qind e buxhetit vendor është përdorur për investime

